



# Koha



**Teknologjia, pse duhet ta kemi frikë?**

Fq.18

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3476 · e enjte, 4 tetor 2018

15°C | 20°C

15 DEN

## EDITORIAL

**Britanikët që votuan BREXIT-in a ishin Lindorë?!**



Më e rëndësishme se shifrat, janë qëndrimet politike të shqiptarëve kundrejt çështjeve që ishin të përfshira në referendumin e së dielës. Asnjë subjekt serioz politik shqiptar dhe asnjë asociacion intelektualësh në Maqedoni, nuk doli paraprakisht me thirrje për ta bojkotuar referendumin. Shqiptarët mund të kenë pasur një mijë e një arsye për ta bojkotuar referendumin...

Fq.2

## RAJON

**Vuçiç i gatshëm të njohë pavarësinë e Kosovës**

Fq.14

## AKTUALE

**Gërmimet nuk do të fillojnë, harrohet Kalaja e Tetovës**

Fq.9



## VENDI PARA VENDIMEVE TË MËDHA POLITIKE

# PA SHUMË SHPRESA EDHE PARLAMENTI



**BDI siç duket ka bindur LSDM-në që procesi të kalojë në Parlament dhe të shikohet mundësia të binden për të votuar ndryshimet kushtuese deputetët e pakicave brenda grupit parlamentar të VMRO-së dhe deputetë të tjerë që nuk janë në vijë me qëndrimet e Mickovskit për referendumin. Po shpresohet edhe në presionin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj VMRO-së, e cila së fundmi po akuzohet si përgjegjëse për izolim ndërkombëtar të vendit**

Fq.3

## Tregtia dhe ndërtimi me më shumë borxhe

Shkup, 3 tetor - Tregtia dhe ndërtimtaria shfrytëzojnë gati gjysmën e totalit të kredive, apo afër 1.4 miliardë euro të mjeteve financiare që bankat miratojnë për biznesin në Maqedoni. Analizat e Bankës Popullore të Maqedonisë për vitin e kaluar tregojnë se 1 miliardë e 50 milionë euro janë miratuar për tregtarët, të pasuar nga kompanitë e ndërtimit me afër 320 milionë euro. Me fjalë të tjera, këto dy sektorë

ekonomike shfrytëzojnë gati gjysmën e totalit të kredive të bizneseve në shtet. Industria e ushqimit ka borxh prej afër 186 milionë euro, industria e tekstilit ka borxh prej 81 milionë euro, ndërsa sektori i bujqësisë afër 78 milionë euro. Ekonomistët thonë se qarkullimi më i shpejtë i parave në tregti, por edhe veprimtaria stabile e shitblerjes së banesave dikton që bankat të preferojnë kreditimin...

Fq.7





## EDITORIAL

# BRITANIKËT QË VOTUAN BREXIT-in A ISHIN LINDORË?!



Emin AZEMI

Më e rëndësishme se shifrat, janë qëndrimet politike të shqiptarëve kundrejt çështjeve që ishin të përfshira në referendumin e së dielës. Asnjë subjekt serioz politik shqiptar dhe asnjë asociacion intelektualësh në Maqedoni, nuk doli paraprakisht me thirrje për ta bojkotuar referendumin. Shqiptarët mund të kenë pasur një mijë e një arsye për ta bojkotuar referendumin, mirëpo ata nuk u bënë palë me taborin e atyre që ëndërrojnë për një Maqedoni tjetër, ku vlerat europiane do të ishin një nocion i huaj dhe i largët.

Askush në Maqedoni nuk disponon me shifra të sakta se sa shqiptarë votuan pro dhe sa kundër referendumit. Nëse ka të dhëna se sa janë prej tyre që nuk kanë dalur të votojnë, kjo nuk mund të përkthet me automatizëm si votë kundër. Është e pandershme të etiketohet një popullatë e tërë si gjoja fajtoresh për fiskon e referendumit, dhe më së paku të thuhet budallallëqe se ata ishin me Lindjen më shumë se me Perëndimin, prandaj bilanci i votave shqiptare doli i tillë. Çka është ky sindrom idiotik që rri pezull në qafat e holla të mendjeshkurtësisë sonë për të projektuar armikun brenda nesh si një mercenar që ushqehet tinëz me bukën e Lindjes, thua se Lindja është një gogol prej të cilit duhet të ketë frikë edhe djalli vet.

Shqiptarët në Maqedoni dhe në gjithë rajonin, janë populli më pro european dhe pro amerikan dhe askush ata nuk mundet t'i spojojë nga ky përcaktim, pavarësisht disponimeve momentale që shprehin në zgjedhje a në ndonjë referendum. Nëse paska mbet një referendum të testojë sensorët civilizues të shqiptarëve, atëherë mjerë ne që do të varemi nga epilogu i atij referendumi.

Çka t'iu themi britanikëve që votuan Brex-it dhe u larguan nga BE? T'i quajmë edhe ata Lindorë?!

Nëse është e vërtetë se regjistri zgjedhor në Maqedoni është i fryrë të paktën për 400 mijë votues, atëherë del që fiascoja e referendumit të mos lidhet gjithaq me "përcaktimet Lindore" të shqiptarëve, por me bojkotin maqedonas dhe me vetë defektin që patën institucionet në përgatitjen e një infrastrukture stabile që do të siguronte rezultate reale e jo virtuale.

Kur jemi të shqiptarët, do të duhej ta evidentojmë edhe një fakt se pikërisht disponimi i tyre për përcaktim është përkthyer gabimisht nga një pjesë dërmuese e bashkëqytetarëve maqedonas, të cilët me automatizëm çdo sensibilitet për përcaktim të shqiptarëve e kanë trajtuar si diversion mbi Maqedoninë. Revanshizmi ndaj NATO-s nëpër sheshet e Shkupit, që përcillej me djegie të flamujve dhe me koktejt molotovi, u bë pikërisht nga bojkotuesit e tanishëm të referendumit, të cilët edhe atëherë, edhe tani, edhe në të ardhmen, do të jenë kundër lidhjeve tradicionale të shqiptarëve me vlerat Perëndimore.

Një Maqedoni me shqiptarë të barabartë dhe me qytetarë të dinjitetshëm në rrafshin social e kulturor, do të duhej të jetë algoritmi i zhvillimeve të ardhshme, sepse kurrfarë Perëndimi as kurrfarë NATO nuk na nevojitet nëse si shoqëri dhe si institucione nuk e meritojmë paraprakisht statusin e të qenit njerëz të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm. Një prej misionëve të politikës së ndershme është pikërisht krijimi i parakushteve për një status të tillë, pa të cilin kot pretendojmë se jemi Perëndimor.

## REALISHT KANË VOTUAR 40.15% E JO 36.91%

"Nëse numri i votuesve është 1,806,402 plus numri i grupmoshës nga 0-17 që është 414,482 që nuk kanë të drejtë vote i bie që numri i banorëve në RM të jetë 2,220,884 banorë.

Mirëpo nga ana tjetër numri i banorëve në RM është 2,075,301 që i bie të jetë për 145,583 banorë më pak se numri i mësipërm prej 2,220,884 banorë. Në qoftë se do të pastroheshite lista zgjedhore numri i votuesve në RM do të ishte përafërsisht 1,660,819 banorë dhe nëse marrim ata që kanë votuar 666,743 votues, i bie që 40.15% kanë votuar", la shkruar një status në Facebook, profesori universitar Izet Zeqiri.



## SHUARJA E AKADEMISË KRYESORE SHQIPTARE

Që të dy akademitë dhe të gjitha institutet shqiptare së bashku nuk kanë kontribuar në studimet shqiptare sa Dr. Robert Elsie i vetëm. Falë kontributit të Elsie-it sot ekzistojnë qindra botime për shqiptarët të vendosura në raftet e librarive dhe bibliotekave në botë.

Veprat e tija përfshijnë studime në albanologji, histori, etnografi etj. Elsie, me botimet e tija në anglisht, gjermanisht dhe frengjisht i ka pasuruar studimet shqiptare dhe ka bërë të mundur inicimin e studimeve të kësaj fushe në shumë universitete të botës. Puna e Elsie-it sot përdoret si referenca kryesore në studimet që kanë të bëjnë me shqiptarët.

Prandaj, vdekja e tij e hershme është humbje e madhe për botën akademike por sidomos për shqiptarët në tërësi. Shqiptarët duhet ta ndejnë vehten krenarë që kishin një mik studjues të tillë dhe njëkohësisht të ndjehen edhe të shkretë për humbjen e tij.

Ata që e kanë njohur Robert Elsie-in e dijnë që është vështirë të gjendet studjues më i mirë dhe njeri që i ka dashur shqiptarët më shumë. Vdekja e tij është shuarje e akademisë kryesore që kanë patur shqiptarët ndonjëherë.

Me të ndjerin për herë të fundit jam takuar në shkurt të vitit të kaluar kur i shkrova disa fjalë dhe i bëra disa fotografi në lidhje me aktivitetin e tij që e kishte titulluar 'Një mbrëmje me Edith Durham-in' e të cilën po e sjellë më poshtë në formë të 'share', ka shkruar një status në Facebook, Daut Dauti.

## ZHËNJIMI ME BUKURINË

Po prisja semaforin jeshil. Përballë, në krahun tjetër të bulevardit, një femër më shumë se e bukur. Perri!

Semafori u hap. Njerëzit lëvizën. Edhe unë. Edhe ajo. Po ecja ngadalë. Doja t'ia shijoj bukurinë. Ia ngula sytë. Bukuri e përsosur... derisa futi njërin gisht tregues në hundë, e shtyu fort, e nxori dhe, saçmën që bëri sa hap e mbyll sytë, e hodhi shkujdesur në bulevard.

O Zot, sa e shëmtuar u bë ajo perri", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Tirana, Urin Bajrami.



## MEDIA Citate

### TRUMP I PËRFSHIRË NË MASHTRIM FISKAL

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Donald Trump, ka ndihmuar prindërit e tij t'u shmangen taksave, përfshirë "raste të mashtrimit të plotë", tregoi një raport i botuar nga gazeta The New York Times. Një investigim i gazetës i bazuar në raportet konfidenciale tatimore dhe regjistrimet financiare zbuloi se Trump ishte pjesë e "skemave të dyshimta tatimore" gjatë viteve 1990 që "ndjeshëm rritën pasurinë që ai pranoi nga prindërit e tij". Gjatë fushatës së tij presidenciale, Trump pretendoi se ai kishte krijuar kompaninë e tij dhe kishte marrë shumë pak para nga familja e tij, duke shpallur veten një "miliarder të vetëbërë". Por, sipas hetimeve të The Times, ai kishte pranuar nga familja ekuivalentin e sotëm prej 413 milion dollarësh nga patundshmëritë e babait të tij, Fred Trump. "Pjesa më e madhe e këtyre parave erdhi tek Trump sepse ai ndihmoi prindërit e tij të shmangnin taksat", shkruan The New York Times. "Ai dhe vëllezërit e motrat e tij krijuan një korporatë mashtruese për të maskuar miliona dollarë në dhurata nga prindërit e tyre, tregojnë regjistrat dhe intervistat. Të dhënat tregojnë se Trump ndihmoi babanë e tij të fitojë zbritje tatimore të papërshtatshme me vlerë milionëshe", thuhet më tej. Sipas gazetës, gjetjet bazohen në intervistat me ish-punonjësit dhe këshilltarët e Fred Trump, ndërsa ka analizuar më shumë se 100.000 faqe të dokumenteve të familjes Trump, duke përfshirë shënime, raporte financiare, dosjet të gjykatave civile, deklarata bankare, auditime financiare, fatura dhe regjistra rregullatorë. Raporti shtoi se prindërit e presidentit, Fred dhe Mary Trump, "u kanë transferuar më shumë se një miliardë dollarë pasuri fëmijëve të tyre, që mund të kishin prodhuar një faturë tatimore prej të paktën 550 milionë dollarë", nga të cilat Trump paguan vetëm 52,2 milionë dollarë. Ndërsa presidenti nuk iu përgjigj pyetjeve të The Times, avokati i tij, Charles J. Harder, hodhi poshtë akuzat. "Pretendimet e New York Times për mashtrim dhe evazion fiskal janë 100 për qind të rreme dhe shumë shpifëse", tha ai në një deklaratë me shkrim.

(New York Times, 3 tetor)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### KUSH ISHTE KLITI?

Kliti ishte mbret ilir, i biri i Bardhylit. Përmendet nga burimet më 335 p.e.s. lidhur me përpjekjet për të shkëputur nga sovraniteti maqedon mbretërinë ilire të dobësuar pas vdekjes së Bardhylit më 357. Kliti zgjodhi vitin 335 si momentin më të përshtatshëm për organizimin e kryengritjes, meqë në këtë kohë pasardhësi i

Filipit II, Aleksandri ishte duke luftuar jashtë vendit me tribalët dhe me popullsi të tjera veriore. Kliti u përkrah nga Glaukia dhe pushtoi qytetin e Pelionit, por nuk mundi t'ia arrijë qëllimit. Aleksandri me forca të shumta e rimori Pelionin dhe e shtrëngoi mbretin ilir të mërgohej te taulantët.



BDI siç duket ka bindur LSDM-në që procesi të kalojë në Parlament dhe të shikohet mundësia të binden për të votuar ndryshimet kushtuese deputetët e pakicave brenda grupit parlamentar të VMRO-së dhe deputetë të tjerë që nuk janë në vijë me qëndrimet e Mickovskit për referendumin. Po shpresohet edhe në presionin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj VMRO-së, e cila së fundmi po akuzohet si përgjegjëse për izolim ndërkombëtar të vendit

PARA VENDIMEVE TË MËDHA POLITIKE

# PROCESI PA SHUMË SHPRESA KALON NË PARLAMENT



Angela Merkelit, CDU dhe partisë CSU në Bundestagun gjerman, Johan David Vadelul. Ai ka vlerësuar se opozita maqedonase nuk guxon ta bllokojë perspektivën e Maqedonisë për NATO dhe BE. Ata paralajmërojnë se mossa e marrëveshjes për Emrin do ta izolojë vendin gjatë kohë. "Në referendum, më shumë se 91 për qind e votuesve kanë votuar për ndryshim të emrit të shtetit në 'Maqedonia e Veriut', ndërkaq njëkohësisht edhe për perspektivën e mëtutjeshme të vendit në NATO dhe BE. Por, censusi i nevojshëm prej 50 për qind nuk u arrit. Prej këtui, vendimtare do të jetë votimi në Parlament", thotë Vadelul. Grupi i deputetëve CDU/CSU thotë se u vjen keq që vetëm 37 për qind e votuesve kanë marrë pjesë në referendumin për ndryshimin e emrit, dhe se nuk është arritur censusi. Grupi i deputetëve CDU/CSU e fton opozitën e Maqedonisë të pajtohet me, siç thonë ata, votimin historik dhe të rëndësishëm në Parlament për ndryshim të amendamenteve kushtetuese, pasi në të kundërtën, do të ishte përgjegjëse për bllokimin e rrugës për Maqedoninë në afat të gjatë dhe me atë të izolohet vendi nga Evropa.

Ndryshe, reagimi i CDU/CSU vjen pasi opozitarja VMRO-DPM-NE ka deklaruar se nuk do t'i përkrahë ndryshimet kushtetuese për Marrëveshjen me Greqinë, të cilat janë parakusht për anëtarësim në NATO dhe fillim të negociatave me BE-në. VMRO të mërkurën në ora 19 ka thirrur mbledhje të Komitetit Qendror. Burime nga partia e Mickoskit nuk konfirmojnë nëse do të marrin ndonjë vendim, megjithatë ajo që dihet është se çështja më pas do të shqyrtohet edhe në Komitetin Ekzekutiv dhe në grupin parlamentar të VMRO-së.

## QEVERIA PA PLAN PËR PASTRIMIN E LISTËN ZGJEDHORE

Në pyetjen e Gazetës KOHA se kur do të kemi një qasje serioze dhe një plan konkret nga Qeveria për pastrimin e Listës Zgjedhore, kur dihet e LSDM sa ishte në opozitë dhe gjatë Qeverisë teknike kishte kritika të shumta për votues fiktiv, zëdhënësi Mile Boshnjakovski gjatë Konferencës për shtyp tha se Qeveria është njëri segment kur duhet të adresohen problemet, ndërsa ka dhe institucionet tjera që sipas tij duhet të punojnë në këtë drejtim. "Ekzistojnë shumë segmente që duhet të adresohen. Disa prej tyre janë detyrë e Qeverisë, ndërsa disa detyrë e institucioneve tjera. Në Maqedoni, nga viti 2002 nuk kemi Regjistrim të popullsisë, por për momentin

vijojnë përgatitjet në Entin Shtetëror të Statistikave për mbajtjen e regjistrimit. Janë trashëguar më shumë probleme që duhet të adresohen dhe të zgjidhen. Jemi të vetëdijshëm të gjithë se mbi 400 mijë bashkëqytetarë tanë nuk jetojnë në Maqedoni, ndërsa i kemi në Listën zgjedhore si qytetarë të Maqedonisë. Edhe kjo ka komplikime në të gjitha proceset zgjedhore, por edhe në referendum. KSHZ në periudhën e ardhshme ndoshta do të intervenojë në lidhje me Listën zgjedhore, megjithatë të gjitha institucionet duhet në mënyrën e duhur të adresojnë problemet dhe të zgjidhen", tha Boshnjakovski.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 3 tetor - Qeveria e Maqedonisë mbetet në qëndrimin zyrtar që Marrëveshja për emrin me Greqinë të zbatohet në Parlament përmes votimit të ndryshimeve kushtetuese, dhe në rast se nuk do të kalojë, atëherë do të shikohet mundësia për ta çuar vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kështu tha të mërkurën gjatë një konference për shtyp zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, sipas të cilit, Qeveria pret mbështetjen edhe të deputetëve të VMRO-së.

"Në presim që deputetët e opozitës të lexojnë qartë dhe në mënyrë të drejtë vullnetin e qytetarëve në referendum. Mbi 600 mijë qytetarë votuan pro Marrëveshjes së Prespës. Nuk kemi asnjë dilemë se procesi për momentin është në Parlament dhe se është i nevojshëm sigurimi i shumicës prej 2/3 të votave për implementimin e Marrëveshjes me Greqinë përmes votimit të ndryshimeve kushtetuese", tha Mile Boshnjakovski. Në pyetjen e gazetës KOHA nëse pushteti do të bisedojnë me deputetë të caktuar të opozitës nëse nuk ka bisedime direkte me VMRO-në si parti, Boshnjakovski tha se së pari do të shkohet përmes procedurës në Parlament dhe nëse vërtetë nuk ka sukses, tek atëherë do të shikohen zgjedhjet e parakohshme si opsion i fundit.

Nga ana tjetër, jozyrtarit merret vesh se BDI e Ali Ahmetit këmbëngulë më shumë se çdo parti tjetër që procesi të kalojë sa më shpejtë në Parlament dhe të tentohet të binden disa deputetë

të opozitës, mes atyre që ishin kundër qëndrimin zyrtar për referendumin dhe që dolën të votojnë dhe deputetë të pakicave që ende janë në grupin parlamentar të VMRO-së. Sipas burime anonime partiake, BDI në bazë të analizave të brendshme - nuk është e sigurt se edhe me zgjedhje të parakohshme mund të arrihet shumica prej 2/3 e votave apo 81 deputetë. Që të ndodh kjo, BDI pret aktivizimin e shpejtë të bashkësisë ndërkombëtare. Po nga LSDM në kushte anonimiteti për gazetën KOHA thonë se varianti për të bindur deputetët veç e veç, qoftë dhe përmes votimit të fshehtë, është me rrezik dhe nuk presin rezultat pozitiv.

"Nuk është koha e Lupço Georgievskit kur kishte kalime deputetësh, është kohë tjetër tani aq më shumë kur Mickovski vepron në diktat të Nikolla Gruevskit. Veç një dihet, se amnistia nuk do të ketë. Pazare politike nuk do të bëhen me funksionarë të VMRO-së që janë nën hetime në këmbim të votës për ndryshime kushtetuese. Shkuarja në zgjedhje do të ndihmojë vendit më shumë, sepse do të

dihen kush janë izoluesit e Maqedonisë dhe deri ku mund ta çojnë Maqedoninë dhe kush po punon për të hequr Maqedonisë nga izolimi dhe për ta bërë shtet anëtar të NATO-s", thonë zyrtarë partiak nga LSDM.

Ndryshe, pozicioni i VMRO-së kundër Marrëveshjes për emrin që të mos votojë ndryshimet kushtetuese, vetëm se ka nisë të merr kritika të forta dhe atë nga partitë mike të saj siç është Unioni Kristian Demokrat i Gjermanisë (CDU) e

Angela Merkelit. Deputetë nga kjo partia në Bundestagun gjerman kanë përmendur izolimin e mundshëm të VMRO-së nëse del kundër ndryshimeve kushtetuese e rrjedhimisht, kundër hyrjes së vendit në NATO.

"Me mbi 91 për qind 'PËR', votuesit në Maqedonia kanë dhënë mbështetje të madhe për rrugën evropiane dhe për perspektivë më të madhe të vendit të tyre në BE dhe NATO", ka porositur kryetari i grupit parlamentar të partisë së

## STOLTENBERG: MARRËVESHJA ME GREQINË, RRUGA E VETME DERI NË NATO

Drejt përdrejt para fillimit të takimit të ministrave të mbrojtjes të anëtarëve të NATO-s, sekretari i përgjithshëm i Aleancës, Jens Stoltenberg, porositi edhe një herë se Marrëveshja me Greqinë është rruga e vetme për hyrje në këtë dhe në organizata të tjera, por se vendi në mënyrë sovranë duhet të vendosë nëse dhe si do ta bëjë këtë, përmes Kuvendit apo zgjedhjeve të parakohshme. "Nuk ka rrugë alternative për hyrje në NATO pa zgjedhje të përbashkët të dakorduar me Greqinë. Pikërisht për shkak të kësaj e përshëndeta Marrëveshjen me Greqinë de plotësisht e mbështes implementimin e saj", tha Stoltenberg. Ai theksoi se



kompromisi me Greqinë dhe hyrja në NATO do të jetë përparësi e madhe për Maqedoninë dhe për rajonin. "Do ta pranojmë vendin si anëtarja e 30-të, por marrëveshja për emrin patjetër të implementohet", thotë Stoltenberg.

Sekretari i përgjithshëm përkujtoi në përfitimet që i ka sjellë anëtarësimi i Malin e Zi në NATO. Ai megjithatë, refuzoi të përgjigjet në pyetjen për përzjerje të mundshme ruse në proceset politike në Maqedoni. Burime të larta diplomatike në NATO tregojnë në atë se "nëse Rusia me të vërtetë angazhohet për stabilitet të vendit ajo do ta mbështeste referendumin".



Sipas ekspertëve ekonomik dhe përfaqësuesve të biznesit, thënia "JO" BE-së dhe NATO-s do të reflektohet drejtpërdrejt në ekonominë e vendit, sepse derisa kompanitë vendore dhe ato të huaja nuk do të përmirësojnë konceptin e rrogave të ulta, jo vetëm të rinjtë - por edhe të punësuarit në numër të konsiderueshëm do të braktisin vendin qoftë edhe për periudha të shkurta në vendet e BE-së për rrogë më të mëdha

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 3 tetor - Integrimi i Maqedonisë në BE dhe NATO apo mbetja jashtë këtyre dy institucioneve ndërkombëtare edhe për shumë vite tjera, nuk do mund ta ndalon procesin e shpërnguljes së shtetasve të Maqedonisë drejt vendeve evropiane e në veçanti të rinjtë si fuqi punëtore profesionale. Kjo, sipas ekspertëve ekonomike dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit nga sektori privat, thënia "JO" BE-së dhe NATO-s do të reflektohet drejtpërdrejt në ekonominë e vendit, sepse derisa kompanitë vendore dhe ato të huaja nuk do të përmirësojnë konceptin e rrogave të ulta, jo vetëm të rinjtë, por edhe të punësuarit tjerë në numër të konsiderueshëm do të tentojnë ta braktisin konceptin e rrogave të ulëta me produktivitet të ulët që e kemi tani, dhe do të ikin të punojnë qoftë edhe për periudha të shkurta në vendet e BE-së për rroga më të mëdha. Nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) vlerësojnë se në rast të ngecjes eventuale apo dështimit eventual të Maqedonisë drejt integritimit në NATO dhe Bashkimin Evropian, sigurisht se kërcënohet largimi i një numri të madh të fuqisë punëtore profesionale.

"Njëra prej arsyeve për largimin e të rinjve profesional është për shkak të pasigurisë ekonomike

MOS HYRJA NË BE DHE NATO PËRSHPEJTON PROCESIN E IKJES SË TË RINJVE

## KUR DËSHTON POLITIKA, DËSHTON EDHE EKONOMIA



me të cilën mund të ballafaqohet Maqedonia. Padyshim që mungesa e kuadrove profesional dhe cilësor do të ndikojë rëndësishëm në produktivitetin e kompanive dhe në përgjithësi në ekonominë e vendit, prandaj ne vlerësojmë që përveç integritimit në NATO dhe BE, që do të sillte stabilitet dhe prosperitet në vendin tonë, duhet të fokusohemi edhe në krijimin e kushteve të volitshme për mbajtjen apo zvogëlimin e numrit të rinjve që po largohen masovikisht jashtë vendit", thonë nga OEMVP-ja. Nga kjo odë ekonomike shprehen optimistë edhe përkundër bojkotit të referendumit se Qeveria do të gjejë modalitetin që Maqedonia të jetë pjesë e BE-së dhe NATO-s, përndryshe do të ketë turbulencë politike si që kemi pas në të kaluarën.

"Jemi dëshmitarë nga e kaluara se kur vendi ballafaqohet me ndonjë krizë apo turbulencë politike dhe institucionale, komuniteti i biznesit nuk është i anashkalluar dhe ajo padyshim që ndikon në mënyrë direkte dhe indirekte në stagnimin apo zvogëlimin e produktivitetit të biznesit", thonë nga OEMVP-ja. Profetori i ekonomisë pranë Kolegjit Amerikan në

Shkup, Marjan Petreski, thotë se Maqedonia me hyrjen në BE dhe NATO, do të fitonte një siguri më të madhe jo vetëm në aspektin e sistemit afarist, por edhe në vendosjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sundimit e drejtësisë.

"Problemi kyç që kemi një rritje ekonomike anemike, në parim ka të bëjë me paaftësitë institucionale, potencialit kadrovik të determinuar, si dhe mosbesim e qytetarëve dhe kompanive në këto institucione. BE dhe NATO janë garanci se institucionet shtetërore do të përforcohen dhe përsëri do të sundojnë drejtësi. Njëherazi, ky është edhe parakushti kryesor që ekonomia e një shtetit të ketë rezultate pozitive dhe rritjen e standardit jetësor të qytetarëve", thotë Petreski, ekspert ekonomik.

Në anën tjetër, edhe eksperti ekonomik Fatmir Bytyqi, është i mendimit se me anëtarësimin në NATO, për shtetin do të thotë siguri më e madhe që në aspekt gjeopolitik - do të thotë që për investitorët e huaj është një shtytje e jashtëzakonshme dhe siguri për investimet e tyre. "Shembujt shteteve të tjera që kane kaluar në situatë të ngjashme është shumë

pozitive. Rritje e BPV në mënyrë të konsiderueshme. Hyrja në BE, nga ana tjetër përveç përparësisë që jep vete anëtarësimi dhe fondet e mundshme të cilat janë në sasi të konsiderueshme ose nëse tani kemi në dispozicion 664 milion, atëherë mund të presim diku rreth 10 herë më shumë fonde. Ky është rast tipik me Kroacinë. Për ekonominë, gjithashtu kjo do të thotë treg më i madh me rreth 520 milionë konsumatorë të mundshëm", shprehet Bytyqi. Ndërsa me mos anëtarësimin BE dhe NATO, Bytyqi thotë se realisht Maqedonia privohet nga mundësia për të shfrytëzuar të gjitha këto mundësi.

"Komuniteti i biznesit mendoj se sfidën kryesore në këtë periudhë do ta ketë ngritjen e konkurrencës së tyre përkundër sfidave të tregut të ri dhe sfidave të reja. Mendoj se kompanitë tona duhet në kohë të fillojnë të mendojnë për të investuar në inovacione dhe ngritjen e konkurrencës së tyre globale jo duke u nis nga nevojat lokale, por nga sfidat globale dhe sfidat dhe kërkesat e konsumatorëve në tregun më të gjerë të Bashkimit Evropian", thotë Bytyqi.



### Rajoni nuk është eksportues i destabilitetit në Evropë

Shkup, 3 tetor - Në këto hapësira, ne nuk jemi eksportues të destabilitetit drejt Evropës, por jemi zonë transitorë, edhe kur është në pyetje kontrabanda e narkotikëve, e armëve dhe radikalizimit. Për këtë arsye dëshirojmë të kontribuojmë në stabilizimin e përgjithshëm dhe në rritjen e nivelit të sigurisë nëpër hapësirën evropiane, por me definim plotësisht të qartë se problemet nuk rrjedhin prej këtu. Kemi obligim serioz t'i parandalojmë ato procese transitorë dhe për atë arsye dëshirojmë të realizojmë edhe koordinim më të mirë nacional dhe bashkëpunim rajonal në këtë sferë. Këtë e deklaroi Goran Svillanoviç, sekretar i përgjithshëm i Këshillit për bashkëpunim rajonal me seli në Sarajevë, i cili së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Oliver Spasovski, folën në seminarin rajonal me temë "Preventiva/lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm" në organizim të Këshillit rajonal për bashkëpunim dhe Komitetit nacional për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit. Svillanoviç tha se ideja është të mundësohet koordinimi i nivelit nacional të institucioneve të ndryshme - ministrive të Punëve të Brendshme, të Drejtësisë, Drejtorisë për kryerje të sanksioneve, si dhe pjesëve të tjera nga Qeveria të angazhuara për sigurinë. "Dëshirojmë të dakordohemi se si në nivel nacional të bëhet koordinimi, si të bashkëpunojmë në mënyrë rajonale", tha Svillanoviç, duke shtuar se është shumë me rëndësi të punohet me bashkësitë lokale. Ai theksoi se ky seminar është dedikuar për ekspertët dhe qëllimi është ata nesër të jenë në gjendje të angazhohen, secili në bashkësinë e vet dhe secili në shtetin e vet. Me atë rast të dinë cilët i kanë partnerë nga ana tjetër e kufirit, të cilët mund t'u ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve. Svillanoviç paralajmëroi se sot do të jetë në Tiranë, ku do të ketë tubim të ministrave të punëve të brendshme dhe të drejtësisë nga rajoni, ndërsa nikoqir do të jetë komisar i evropian Avramopoulos, i cili do t'i kumtojë elementet e reja nga Plani i aksionit që e ka përgatitur KE-ja për atë se si të na ndihmohet dhe si të bashkëpunohet me BE-në. Kjo, siç tha, është problem që i tejkalon kufijtë tanë dhe ne jemi vetëm pjesë e hartës në hapësirën e gjerë evropiane.

### 23 VJETORI I ATENTATIT NDAJ ISH-PRESIDENTIT GLIGOROV

## HETIMI QË NUK PO MERR FUND

Shkup, 3 tetor - Nëse ka momente të reja në hetimin për atentatin ndaj presidentit të parë të Maqedonisë, Kiro Gligorov, ato do të ndahen me opinionin, deklaroi ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski në ditën kur para 23 vitesh ndodhi atentati. "Për të gjitha punët, edhe për këtë, nëse kemi njohuri të reja ne i ndajmë me opinionin, në frymën e transparencës. Gjithçka ekziston do të publikohet, jo vetëm për atentatin. Ajo është diçka që sot na e përkujton atë ditë edhe për aktivitetet e tjera të cilat i ndërmerr Ministria e Punëve të Brendshme", tha Spasovski, duke

iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve pas hapjes së seminarit rajonal "Parandalimi/lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm". Para 23 vitesh më 3 tetor është kryer atentat ndaj presidentit të parë të Republikës së Maqedonisë, Kiro Gligorov, i cili e mbijetoi atë me lëndime të rënda në kokë. Në vendin e atentatit jetën e humbi shoferi i tij Aleksandar Spirovski, ndërsa është lënduar truproja e Gligorovit, Illço Teovski. Si pasojë e lëndimeve vdiq edhe kalimtari i rastit, Hristo Hristomanov, ndërsa u lënduan edhe Klime Korobar dhe Jovan Atanasovski. Mbetet e panjohur se kush

ka qëndruar pas atentatit. Procedura hetuese e cila po zhvillohet kundër një kryerësi të panjohur ende është e hapur. Hetimi konfirmoi se atentati ka qenë i përgatitur dhe organizuar mirë dhe se vetëm rrethanë fati është që presidenti Gligorov e mbijetoi atentatin. Sulmi është kryer me automobil bombë më 3 tetor të vitit 1995 në orën 9:50 në rrugën "Maqedonia" para hotelit "Bristol" në Shkup kur Gligorovi me automjetin zyrtar lëvizte nga rezidenca e tij drejt vendit të punës në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Në automobilin "citroen ami 8" janë

fshehur 20 kilogramë eksploziv, i cili është aktivizuar me telekomandë kur automjeti i Gligorovit lëvizte drejt ndërtesës së Kuvendit. Në hetimin janë bastisur 30.850 automjete dhe janë kontrolluar mbi 15.000 objekte, janë legjitimuar mbi 188.000 persona prej të cilëve 19.000 janë kontrolluar. MPB ka kryer edhe më shumë biseda informative me njerëz për të cilët është vlerësuar se janë autorët e mundshëm të atentatit, por të gjithë ata janë lëshuar pasi janë marrë në pyetje. Gligorov vdiq më 1 janar të vitit 2012 në moshën 94-vjeçare. (R.K)



ANTIKORRUPSIONI PA KOMISION TË RI

# NË ETHET E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

Ashtu sic mbajtja e Referendimit kaloi pa Komisioni shtetëror për antikorruption, ngjashëm pritet të realizohet edhe procesi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Problemi kryesor të cilët autoritetet e Ministrisë së Drejtësisë nuk e kishin paramenduar është çështja e zgjedhjeve të parakohshme që me automatizëm nënkuptojnë shpërbërjen e Kuvendit dhe shumicës parlamentare



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 3 tetor - Miratimi i Ligjit të ri për luftë kundër korrupsionit dhe zgjedhja e Komisionit shtetëror të ri për antikorruption, sipas të gjitha gjasave nuk do të ndodhë në fund të këtij muaji. Zhvillimet e fundit politike dhe paralajmërimet për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, në masë të madhe do të stopojnë procedurat për miratimin e një varg ligjesh, përfshi edhe Ligjin për antikorruption, që ende nuk është dorëzuar në Kuvend.

Kryesuesja e Platformës së organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit, Ana Janeska Delleva, në debatin e fundit për Propozim-Ligjin e ri për antikorruption, theksoi se duhet të bëhet përpjekjet maksimale që së paku të formohet një Komision i përkohshëm që do të monitorojë zgjedhjet eventuale që thuhet se do të mbahen.

"Në bazë të paralajmërimeve se do të mbahen zgjedhje të parakohshme parlamentare, vlerësojmë se në përputhje me dispozitat e vjetra të Ligjit për luftë kundër korrupsionit, të zgjidhen anëtarë të ri të Komisionit shtetëror për antikorruption, për shkak se tejatë e rëndësishme është kontrolli i procesit të zgjedhjeve, mënyra e financimit të partive e kështu me radhë. Kryetari i ardhshëm i Komisionit shtetëror për antikorruption duhet të ketë integritet. Ne si

sektor civil këtë e kemi kërkuar dhe këto kritere janë paraparë në Propozim ligjin e ri. Mendojmë se kryetari i ri i këtij Komisioni duhet të zgjidhet dhe intervistohet publikisht. Në këtë mënyrë i gjithë opinioni duhet të njoftohet me aftësitë dhe integritetin e tij për të udhëhequr këtë institucion", tha Janeska-Delleva.

Por, përkundër kërkesave të sektorit civil që zgjedhja e Komisionit shtetëror për antikorruption të realizohet së shpejti, situata në terren aspak nuk e mundëson një gjë të tillë. Qëndrim zyrtar i LSDM-së është se nëse deri me 10 tetor VMRO-DPMNE nuk pranon të votojë ndryshimet kushtetuese, atëherë po atë ditë Parlamenti pritet të shpërbëhet dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktohet me datë 25 nëntor. Në këto rrethana kur Ligji për antikorruption ende nuk është dorëzuar në Parlament, ndërsa deputetët po i përfundojnë ditët e fundit të mandatit të tyre para zgjedhjeve të parakohshme, zgjedhja e Komisionit shtetëror për antikorruption as që po diskutohet. Ndryshe, prolongimi i afatit për shpërbërjen e Parlamentit me automatizëm e vështirëson arritjen afateve për ndryshimet kushtetuese që mendohet të ndodhin pas zgjedhjeve, gjegjësisht të njëjta duhet të kalojnë në Parlamentin Grek, deri në mars të vitit të ardhshëm.

Ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska,

duke folur për nevojën e miratimit dhe zgjedhës së Komisionit shtetëror për antikorruption, nënvizoi se ky komision duhet të zgjidhet sa është e mundur më shpejt dhe i njëjti duhet të ekzistojë gjatë zgjedhjeve eventuale.

"Deri më tani nga sektori civil kam dëgjuar komente dhe udhëzime të ndryshme për Ligjin për luftë kundër korrupsionit. Por sugjerime dhe propozime nuk morëm nga partitë relevante politike që janë pjesë e Kuvendit, rreth këtij ligji. Nëse për ata ky version dhe plotësimi i vogël që do të bëhet ditëve të ardhshme është i pëlqyer, ne jemi të gatshëm menjëher ta dorëzojmë në Kuvend. Sa i përket kompetencave dhe obligimeve që na takojnë neve si Ministri e Drejtësisë, ne i përmbushim në afatin e kërkuar. Nuk mund të them se do të vazhdohet apo jo me ndryshimet Kushtetuese ose Kuvendi do të shpërbëhet. Saktësisht nuk mund ta parashikojë zhvillimin e aktiviteve", tha ministrja Deskoska.

Nga debati i deritashimë për Propozim-Ligjin për luftë kundër korrupsionit, siç njoftojnë nga Ministria e Drejtësisë, kanë arritur disa komente që do ta ndryshojnë tekstin ligjor. Njëkohësisht në vendin tonë qëndron një Komision teknik i GREKO-së, që monitoron kornizën ligjore dhe disa akteve të caktuara që lidhen me çështjen e luftës kundër korrupsionit.

## Jankullovska përlohet në Gjykatë

Shkup, 3 tetor - "I padrejtë dhe i njëanshëm", kështu ish ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska, e ka vlerësuar gjykimin e ndaras kundër saj për rastin "Tank". Gjatë dhënies së fjalëve përfundimtare ajo të mërkurën në Gjykatën Penale të Shkupit, filloi edhe të qaj duke u arsyetuar se për shkak të fëmijës së saj dy mujour nuk ka mundur të përgatitë mbrojtje kualitative.

"Ky proces ndaj meje zhvillohet në rrethana të jashtëzakonshme. Njëanshmëria ekziston të shumica e e këshillit penale i cili publikisht e shprehi mendimin e tyre se jam fajtores ende pa e miratuar vendimin kundër Gjoko Popovskit dhe Nikolla Gruevskit. Njëanshmërinë e tyre argumenton



fakti se ato në mënyrë të përsheptuar dëshirojnë të miratojnë vendim. Në fillim të këtij procesi gjyqësor duhet të kujde-

sem për fëmijën tim dy mujour, i cili tash i ka tre muaj", tha e përlohet Jankullovska. Ajo, po ashtu i refuzoi akuzat e Prokurorisë Speciale Publike se kinse e ka keqpërdorur pozitën zyrtare si kryeshefe e policisë dhe se me urdhër të ish kryeministrit Nikolla Gruevski, e ka udhëzuar ndihmës ministrin Popovski, ta trukoje tenderin për favorizimin e kompanisë "Makautostar", respektivisht të blej mercedesin e shumë përfolur "S600 Gard".

Ndryshe, Gjykata e Apelit brenda këtyre ditëve duhet ta publikoi vendimin për ankesën e parburgimit ndaj Gruevski dhe Shkupit, vendimin kundër Jankullovska pritet ta shqiptoi me datë 8 tetor. (O.Xh)

## KRONIKË

### Mashtrohet 60-vjeçari në Gostivar

Të martën rreth orës 09.30, 60vjeçari G.Q. ka denoncuar se në rrugën "Ilindenska" në Gostivar, së pari ka takuar një person të panjohur, ku më pas i është afuar edhe një tjetër person, goja se shtetas i huaj, dhe i kanë kërkuar të holla për operacion që duhet të kryerj gruaja e tij. Personi G.Q. nga Gostivari i ka dhënë 13 mijë denarë, dhe 50 euro, kurse i panjohuri që është prezantuar si shtetas i huaj, i ka premtuar dhuratë prej 500 euro, sapo të tërheq të hollat nga banka, dhe si garancë se do të kthehen me personin tjetër, e ka lënë një "orë prej diamanti". Pasi dy personat janë larguar dhe nuk janë kthyer më, personi G.Q. ka kuptuar se e kanë mashtruar. Po ndërmerren të gjitha masat dhe aktivitetet për gjetjen dhe identifikimin e mashtruesve njofton policia e Gostivarit.

### Digjen dy automjete në një garazh me kate në Shkup

Në garazhin me kate në rrugën "Stefan Jakimov Dedov" në Shkup është përfshirë në flakë një makinë "Mercedes" me targa të Shkupit, në pronësi të K.B. nga Shkupi. Siç informon sot MPB, rasti është denoncuar në polici në mëngjesin e sotëm në orën 1.39. Nga zjarri ishte përfshirë edhe një makinë "Pezo 106" me targa të Shkupit, në pronësi të M.A. nga Shkupi. Policia po ndërmer masa për ndriçimin e rastit

### Dy persona sulmojnë të riun tetovar

Të martën rreth orës 20 e 50 minuta, 19 vjeçari R.B. nga fshati Strimnicë e Tetovës, ka denoncuar se një orë më herët, në afërsi të Spitalit Klinik të Tetovës, ka qenë i sulmuar fizikisht nga 22 vjeçari R.R. nga fshati Zhelinë dhe 21vjeçari A.J. nga Tetova. Dy personat e denoncuar janë thirrur në Stacionin policorë Tetovë, dhe rasti është duke u zbardhur njofton Policia e Tetovës.

### Për një ditë merren 20 vetura

Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, sektori për siguri në trafik dhe rrugë Tetovë, gjatë këtyre ditëve ka intensifikuar kontrollat dhe aktivitetet kontrolluese, për rend më të madh me parkimin e veturave në qytet dhe sanksionimin ligjor të veturave të cilat janë gabimisht të parkuara. Vetëm gjatë ditës së martë, në Tetovë, nga ana e automjetit të mërimengës janë marrë 20 vetura, të cilat kanë qenë gabimisht të parkuara, si dhe pesë vetura, të cilat i kanë drejtuar persona pa leje për vozitje. Këto dhe kundërvajtje tjera janë rumbullaksuar me 20 fletëpagesa për kundërvajtje dhe 41 fletëpagesa të detyrueshme për kundërvajtje, kurse aktivitetet me intensitet të njëjtë do të vazhdojnë edhe gjatë ditëve të ardhshme. (U.H)



## Pensionet më të larta për 1.8 për qind

Shkup, 3 tetor - Pensionet e shtatorit që pensionistët do të marrin në tetor do të jenë më të larta për 1.8 për qind konform harmonizimit të pensioneve për vitin 2018 për 1.8 për qind i cili që do të bëhet konform rritjes së pagave dhe shpenzimeve për jetesë, kumtoi Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në vlerën e kësaj pagese, në mënyrë retroaktive do të kyçet edhe harmonizimi i ri i pensioneve prej 1.8 për qind për muajt korrik dhe gusht.

"Kjo do të thotë se vlera e mjeteve që pensionistët do t'i marrin në tetor si pension për shtatorin do të jetë më e lartë në krahasim me shumën e pensioneve të paguara për muajt korrik dhe gusht. Me pensionin e tetorit, pensionistët rregullisht do të marrin vlerë të harmonizuar të pensionit me përfshirjen të 1.8 për qind, por pa dallime shtesë nga periudha paraprake", thonë MPPS. Pensioni mesatar për muajin shtator në Republikën e Maqedonisë me harmonizimin e përfshirë prej 1.8 për qind arrin 14.500 denarë, ndërsa në shtator të vitit 2016 ka qenë 13.106 denarë. Ky është harmonizimi i dytë i pensioneve. Harmonizimi i parë i pensioneve ishte bërë në fillim të vitit 2018 dhe ka arrinte 1.69 për qind.

Koha

Remzije BILALLI

Shkup, 3 tetor - Duke parë potencialin e vogël zhvillimor që ka sektori i bujqësisë në vend, Qeveria e Maqedonisë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë po punon për orientimin e të rinjve në hapjen e agrobizneseve, të cilët do të ndikojnë në rritjen e ekonomisë dhe punësimit. Ligji për zhvillimin rural, i cili parasheh 10 mijë euro për të filluar veprimtari bujqësore nga drejtori i Odës për agro-biznes u cilësua si humbje parash sepse është shumë e vogël për fillimin një biznesi serioz.

Investimet të cilat nevojiten për hapjen e një agrobiznesit, vlerësohen se janë mjaft të kushtueshme, pasi sot kërkohet edhe teknologji më moderne për prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore. Krahas kësaj, agrobizneset në vend, vazhdojnë të ballafaqohen edhe me mungesën e financave dhe kushtet e vështira të subvencionimit. Në bazë të ekspertëve të bujqësisë, interesi për bujqësi nuk është në trendin e rritjes jo vetëm në Maqedoni por në të gjithë Ballkanin dhe për ta ndaluar këtë trend duhet të punohet në rritjen e sipërfaqeve bujqësore dhe biznesit primar. Kryetari i Lidhjes së Odave Ekonomike (LOE) Ognen Orovanec, theksoi se çdo biznes nën 50 hektar është humbje, duke u pajtuar me investime më të mëdha të cilët janë bartës të zhvillimit ekonomik. Sektori i agro-biznesit kërkon nga shteti subvencione të njëjta si në Europë, buxheti i të cilit brenda vitit ndahen nga 67 për qind për bujqësinë.

Nga kjo Odë vlerësojnë se ekonomitë e mëdha janë shtytës të zhvillimit, por nuk janë kundër mbështetjes për prodhimet e vogla.

## INVESTIMET NË BIZNESIN AGRAR

# TË PAMJAFTUESHËM

# 10 MIJË EURO PËR BUJQIT E RI



Investimet të cilat nevojiten për hapjen e një agrobiznesit, vlerësohen se janë mjaft të kushtueshme, pasi sot kërkohet edhe teknologji më moderne për prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore

shtetjes për prodhimet e vogla. "Çfarëdo lloj ndihmese do të ishte në favor të bujqve, por zhvillimi bujqësor në 2-3 hektarë do të prodhojmë vetëm humbje. Çka mund të bëhet me 10.000 euro, aq sa është mbështetja për fermerët e rinj nëse e dimë se një traktor kushton shumë shtrenjtë. Bizneset bujqësore mund t'i mbajmë vetëm me dhënie të subvencioneve 30%, por nëse është e nevojshme edhe 90 për qind për kapacitetet përpunuese", tha Orovanec.

Megjithatë, ekspertët e ekonomisë vlerësojnë se është koha që të drejtohem tek bizneset primare

sepe bizneset sekondare dhe terciare janë në numër më të madh dhe për t'u zhvilluar një ekonomi është e nevojshme zhvillim i biznesit primar.

"Për investime në agrobiznes nevojitet kohë por duhet bërë edhe planifikime afatgjate. Me rëndësi është ti stimulojmë të rinjtë të drejtohen në këtë drejtim. Edhe pse 10 mijë euro janë një shumë e vogël, besoj që do të shërbejnë si stimulim për fillim të një biznesi. E rëndësishme është që këto fonde të mos keqpërdoren dhe të shkojnë në duart e duhura", tha për gazetën Koha eksperti për agro-ekonomi

primare, Ruzhdi Matoshi. Mes tjerash ai theksoi se të rinjtë të njëjtën punë e kryejnë edhe në perëndim, mirëpo atje janë më të motivuar duke përfshirë këtu edhe pagat më të larta.

Se numri i ekspertëve bujqësor në Maqedoni është i ulët, këtë e konfirmoi edhe dekani i Fakultetit të Bujqësisë në Shkup, Vjekoslav Tanaseviq, i cili u shpreh se të rinjtë nuk janë të interesuar për bujqësi. Tanaseviq shtoi se ky fakultet nëpërmjet kuadrove profesionale, projekteve të ndryshme dhe kontakteve me bujqit, synon të ndihmojë zhvillimin e agrobizneseve.

## THESARI POPULLOR, PJESËRISHT DREJT ZHDUKJES

# Nuk janë vetëm Shëngjergji dhe Dita e Verës!

Mënyra sesi është festuar shqiptarët vjen e përmbledhur në këtë libër nga etnologu Izaim Murtezani. Sipas tij, kjo datë e kalendarit të festimeve pagane tipike edhe për pjesën shqiptare, por edhe për popuj të tjerë të rajonit, së bashku me Ditën e Verës, Karnavalet ilire të Bozovcës janë vetëm një pjesë e vogël e thesarit popullor që kërkon të valorizohet me urgjencë

Koha

Evis HALILI

Shkup, 3 tetor - Ritualet e festimit të Ditës së Shëngjergjit në Maqedoni (6 maj) tek popuj të ndryshëm janë përmbledhur së bashku në botimin më të fundit të Institutit të Folklorit dhe Drejtorisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. I promovuar në kuadër të shënimit të Vitit evropian të trashëgimisë kulturore 2018, ky libër përmbledh disa punime shkencore disa vjeçare për valorizimin e festimeve të pranverës - Shëngjergji tek të pesë komunitetet etnike, maqedonas, shqiptarë, romë, vllah dhe turq. Qëllimi i këtij libri është potencimi i rëndësisë

që ka diversiteti në shprehjet kulturore të popujve të ndryshëm dhe nevoja për të përfshirë kulturën jomateriale në krijimin e politikave të zhvillimit shtetëror, por edhe ndërkombëtare. Drejtoresha e DMT, Eleonora Petrova Mitevska, gjatë promovimit u shpreh se duke e identifikuar funksionin koheziv që ka trashëgimia jomateriale në shoqëri, në këtë rast Shëngjergji, është shpallur si trashëgimi që bën pjesë në nënkategorinë e rëndësishme së posaçme, në vitin 2011.

"Jemi krenarë që me këtë festë kemi hyrë në trashëgiminë jomateriale botërore kulturore të UNESCO, ndër vendet e para ku në fokus janë bashkësitë etnike dhe jo



populli kryesor që jeton në Maqedoni", u shpreh drejtoresha e DMT gjatë promovimit.

Mënyra sesi është festuar tek shqiptarët vjen e përmbledhur në këtë libër nga etnologu Izaim Murtezani. Sipas tij, kjo datë e kalendarit të festimeve pagane tipike edhe për pjesën shqiptare, por edhe për popuj të tjerë të rajonit, së bashku me Ditën e Verës, Karnavalet ilire të Bozovcës janë vetëm një pjesë e

vogël e thesarit popullor që kërkon të valorizohet me urgjencë.

"Janë shumë festa të tjera, data që lidhen me kalendarin pagan e që janë drejt zhdukjes, për shkak se duke qenë se praktikohen gjithnjë e më rrallë nuk do të kemi mundësi që t'i valorizojmë. Nëse ritualet e ciklit antropologjik, ato të lindjes, rritjes, ritit mortore e të tjera janë ruhen në disa zona dhe jemi ende në kohë që t'i ruajmë, ka

shumë të tjera, si proza popullore, lirika e epika popullore që është vështirë edhe që të valorizohet", thotë Murtezani. Sipas etnologut pavarësisht se viteve të fundit sensibilizimi për këtë çështje është në një nivel më të lartë, shqiptarët janë shumë vonë për të ruajtur thesarin etnologjik, mungojnë kuadrot e specializuar në gusha të ndryshme të etnografisë, por edhe mbështetja financiare për hartimin e elaborateve dhe evidencimin e tyre në Regjistrin nacional të trashëgimisë jomateriale.

"Deri tani kemi valorizuar një pjesë shumë të vogël dhe ky proces po ecën gradualisht, por problemi më i madh që do të kemi edhe në të ardhmen janë mungesa e ekspertëve të kësaj fushe, të themi për të valorizuar vallet, këngët, veshjet, e të tjera. Ne si Institut po bashkëpunojmë edhe me Institutin e Trashëgimisë në mënyrë që valorizimi dhe ruajtja nga zhdukja e thesarit popullor të ecë me një dinamikë tjetër", thotë Murtezani.



“Ligjërish është e obligueshme që çdo student të kryej praktikë, ndërsa çështja e pagesës varet nga universitet dhe kompanitë ku mbarojnë punën praktike. Ndërkaq për punën praktike në shkollat e mesme profesionale është paraparë që përfaqësues të kompanive të jenë edhe mentorë të nxënësve, ku do të kryejnë praktikën por edhe do të paguhen”, thonë nga MASH-i

## MANGËSITË E MËSIMIT PRAKTIK



Për kompanitë është e nevojshme që me anë të një shume simbolike të motivohen studentët për të punuar. Nga Dauti Komerc për gazetën Koha theksuan se target kanë të gjitha profilet sidomos ato deficitare mirëpo shpesh herë nuk mundin ti mbulojnë harxhimet e tyre për më shumë se 2-3 muaj. Ata shtuan se kompanitë janë në bisedime me universitete që praktikant gjithmonë të mbahen në muajt e verës sepse janë në favor të dy palëve, studentët nuk kanë ligjërata ndërkaq shumica e të punësuarve në kompani janë në pushime.

“Tradicionalisht çdo vit marrim disa studentë në punë, ndërsa këtë vit kemi filluar të bashkëpunojmë edhe me disa kompani tjera në mënyrë që të përfshihen studentët në më shumë fusha. Studentëve u paguhet rruga, ushqimi dhe marrin një shumë simbolike prej 6.000 den”, deklaroi Nehar Aliu nga Dauti Komerc. Aliu tha se së bashku me MASH dhe kompani tjera kanë formuar një grup punues për të hartuar një rekomandim për Qeverinë e Maqedonisë në lidhje me punën praktike, ku si target primar do të jenë nxënësit e shkollave të mesme profesionale dhe më pas studentët që përveç teorisë të ndjekin dhe praktikën. Ai shtoi se shumica e kompanive shqiptare kanë filluar ti bashkojnë forcat ekonomike për t'i siguruar praktikantëve praktikë të paguar dhe bursë.

Koha

Remzije BILALLI

Shkup, 3 tetor - Përvoja e parë profesionale mund të fitohet duke qenë student. Çdo student dhe nxënës i shkollës së mesme profesionale gjatë pushimit verorë është i obligueshëm të kryej 1 muaj punë praktike. Mirëpo interesimi i nxënësve është i dobët për shkak se ata nuk paguhen aspak dhe bëjnë harxhime shtesë për të kryer punën praktike.

Nxënësit e shkollave të mesme profesionale dhe studentët vlerësojnë se vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet praktikës, sepse është një ndihmesë e madhe për të përvetësuar profesionin e tyre. Por si motiv për të nxitur interesimin e tyre duhet të ketë një pagesë minimale për ti mbuluar shpenzimet. Si rezultat i mungesës së pagesës nxënësit nuk shprehin interesim për punë praktike dhe për këtë arsye shumë profesorë e kanë hequr si obligim punën praktike. Ndërkaq shumica e studentëve dhe nxënësve vërtetimin e marrin pa shkuar as edhe një ditë në praktikë,

# LIGJ TË RI PËR STATUSIN E PRAKTIKANTIT

gjë që hendikepon profesionalisht rininë tonë. “Nuk është se kemi një shtet i cili motivon rininë me mjete financiare, sepse shteti jonë ka mangësi në plotësimin e gjërave themelore ndaj nxënësve. Praktika me pagesë sigurisht se do ti motivonte nxënësit dhe studentët, ndërkaq perspektiva e shkollave profesionale dhe universiteteve do të ishte më e madhe si dhe gjendja e institucioneve do të përmirësohej”, deklaroi për gazetën tonë, Sejhane Alimi, nxënës në shkollën e mesme të mjekësisë “Nace Bugjoni” në Kumanovë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në një sqarim për KOH-ën ka thënë se kompetencat e tilla nuk janë në kuadër të mi-

nistrisë sepse puna praktike rregullohet nga ana e vetë universitetit në bashkëpunim me kompanitë.

“Ligjërish është e obligueshme që çdo student të kryej praktikë, ndërsa çështja e pagesës varet nga universitet dhe kompanitë ku

mbarojnë punën praktike. Ndërkaq për punën praktike në shkollat e mesme profesionale është paraparë që përfaqësues të kompanive të jenë edhe mentorë të nxënësve, ku do të kryejnë praktikën por edhe do të paguhen”, thonë nga MASH.

## ÇFARË PARASHEH LIGJI PËR PRAKTIKANTËT

Puna e praktike e cila nuk është nën ombrellën e ligjeve normative të MASH, gjithashtu do të rregullohet me ligj. Autoritetet janë të bindur se të rinjtë deri në moshën 29 vjeçare të cilët do të kryejnë praktikën në kompani, duhet të mbrohen nga çdo lloj abuzimi. Angazhimi maksimal do të jetë 6 muaj, dhe për këtë praktikantët do të marrin kompensim parash. Për angazhim deri në 3 muaj do të arrijë në 5000 denarë, nëse qëndrojnë dhe tre muaj të tjerët do të marrin 12,000 denarë. Sektori i biznesit argumenton se fondet që do të ofrojnë për

kompensimin e praktikantëve nuk do të jetë barrë financiare për firmat. Sipas autoriteteve kompetente në botë si dhe në Maqedoni, praktika ka dhënë rezultate të mira, vetëm se në vendin tonë nuk ka qenë e rregulluar me ligj. Në vitin 2017 gjithsej 900 të rinj ishin të përfshirë në programin e praktikës ndërsa prej tyre 445 njerëz janë punësuar. Ndryshimet e reja në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës paraqesin disa inovacione që i referohen drejtpërdrejtë kontratës së punës, pushimi vjetor, pagesës së praktikantëve, punës testuese, shpërblimi dhe të tjera.

## KREDITIMI I BIZNESIT

Tregtia dhe ndërtimtaria shfrytëzojnë gati gjysmën e totalit të kredive, apo afër 1.4 miliardë euro të mjeteve financiare që bankat miratojnë për biznesin në Maqedoni

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 tetor - Tregtia dhe ndërtimtaria shfrytëzojnë gati gjysmën e totalit të kredive, apo afër 1.4 miliardë euro të mjeteve financiare që bankat miratojnë për biznesin në Maqedoni. Analizat e Bankës Popullore të Maqedonisë për vitin e kaluar tregojnë se 1 miliardë e 50 milionë euro janë miratuar për tregtarët, të pasuar nga kompanitë e ndërtimit me afër 320 milionë euro. Me fjalë të tjera, këto dy sektorë ekonomike shfrytëzojnë gati gjysmën e totalit të kredive të biznese-

# Tregtia dhe ndërtimi me më shumë borxhe



ve në shtet. Industria e ushqimit ka borxh prej afër 186 milionë euro, industria e tekstilit ka borxh prej 81 milionë euro, ndërsa sektori i bujqësisë afër 78 milionë euro. Ekonomistët thonë se qarkullimi më i shpejtë i parave në tregti, por edhe veprimtaria stabile e shitblerjes së banesave dikton që bankat të preferojnë kreditimin e këtyre dy sektorëve ekonomik në raport me ve-

primtaritë e tjera ekonomike.

Njëherazi, njohësit e sistemit financiar thonë se projekte të mira janë të gjitha ato që sigurojnë rritje reale dhe zhvillim afatgjatë të kompanive. Këto kritere varen nga suksesi i punës së kompanisë, potencialit të saj të pashfrytëzuar për rritje, likuiditetit, historisë së suksesshme kreditore që tregojnë kthimin me kohë të kësteve, por edhe

menaxhimin e mirë me financat. Faktorë tjerë janë marrja pjesë e kompanisë me një pjesë të parave të saja në financimin e projektit investues, si dhe mundësia që me sukses të paguhen këstet e kredisë, të paguhen harxhimet e saja dhe në fund - të sigurohet fitim i caktuar për biznesin. Në ndërkohë, nga bizneset e tjera, me borxh më të madh ndaj bankave dallohet xehtaria me afër 42 milionë euro, industria kimike dhe e prodhimit të materialeve ndërtimore me afër 108 milionë euro, prodhimtaria e metaleve, makinerive dhe pajisjeve të ndryshme me 188 milionë euro, transporti me 207 milionë euro, kompanitë e sektorit të turizmit dhe hotelevisë me 62 milionë euro e kështu me radhë. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se Banka Komerciale që tradicionalisht mbështet më shumë kompanitë në Maqedoni

ni deri në fund të vitit 2017, në total ka miratuar 605 milionë euro për financimin e bizneseve, ndërsa NLB Banka ka miratuar 378 milionë euro. Stopanska Banka ka miratuar 358 milionë euro gjithsej kredi për biznesin deri në fund të vitit të kaluar. Me fjalë të tjera, tre bankat më të mëdha në Maqedoni deri në fund të vitit 2017, kanë huazuar 1 miliardë e 341 milionë euro për biznesin, që paraqet pak më shumë se gjysmën e të gjithë kredive të biznesit. Nga ana tjetër, të gjitha 11 bankat e tjera komerciale marrin pjesë me gjysmën tjetër në totalin e kredive të bizneseve. Ndryshe, përkundër ankesave të biznesit se bankat nuk kreditojnë mjaftueshëm, megjithatë në dhjetë vitet e kaluara është dyfishuar kreditimi i kompanive prej një miliardë e 250 milionë euro në vitin 2007 në afër 2.7 miliardë euro në vitin 2017.



Nr. 10-10350/2 dt. 02.10.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16,163/16, 64/18, 168/18)dhe Vendim me nr. 10-10350/1 dt. 02.10.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

**KOMUNIKATË**  
**për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 Tetovë**

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, komuna e Tetovës**me nr.teknik 11-3/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë, Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Video Smilevski Bato", rr."Video Smilevski Bato 1", rr.,Video Smilevski Bato 2, dhe rr.,Vëllezërit Miladinov".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 4.43 ha.

Brenda përfshirjes planore të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, A2 - banim në ndërtesa kolektive, D1 - Park për gjelbërim, E2 - Suprastrukturë komunale, E1 - Infrastrukturë komunale.

**ANKETA PUBLIKE** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74, komuna e Tetovës,do të zgjas 10 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 15.10.2018 – 29.10.2018 vjet.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

**PREZANTIMI PUBLIK** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 16.10.2018 në ora 12:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

**Kryetar,**  
**Teuta Arifi**

Në bazë të nenit 6 të Vendimit për dhënien e shfrytëzimit të hapësirës shkollore dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera që lidhen me shkollat fillore të Komunës Qendër - Shkup nr. 08-4089/42 prej datës 18.09.2018 nga Këshilli i Komunës Qendër dhe Pëlqimin e kryetarit të Komunës Qendër nr. 09-4385/3 prej 01.10.2018 v shkolla fillore Dimitar Miladinov Qendër Shkup, rr. Koço Racin nr. 17 tel. 3161-448 , publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**  
Për mbledhjen e ofertave për shfrytëzimin e objekteve të mëposhtme

Është dhënë në shfrytëzim në shkollën fillore Dimitar Milladinov sipas asaj në vijim:

**1. Salla e fizikulturës :**

-Hapësira e përdorur është palestra e shkollës.  
-qëllimi i hapësirës - sport dhe rekreacion i fëmijëve dhe të rriturve  
-koha dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - në orë (60min) në një kohë të caktuar deri në 1(një) vit shkollor, por nëse është e nevojshme për një periudhë më të gjatë apo të shkurtë kohore.  
-Çmimi për shfrytëzimin e hapësirës - 827,00 denarë në orë pa TVSH  
Kriteret për dhënien e përdorimit të palestrës , të cilat janë kusht për lidhjen e kontratës janë :  
-kontribut në zhvillimin e sportit në nivel lokal dhe shtetëror -sukcese garuese në sistemet e ligave  
-punë me kategorinë e të rinjve  
-rekreacion

**2. Sallë solemne :**

-Hapësira e përdorur është një sallë solemne në shkollë  
- qëllimi i hapësirës - sport dhe rekreacion i fëmijëve dhe të rriturve  
-koha dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - në orë (60min) në një kohë të caktuar deri në 1(një) vit shkollor , por nëse është e nevojshme për një periudhë më të gjatë apo më të shkurtë kohore .  
-Çmimi për shfrytëzimin e hapësirës -754,00 denarë në orë pa TVSH  
Kriteret për dhënien e përdorimit të palestrës , të cilat janë kusht për lidhjen e kontratës janë :  
-kontribut në zhvillimin e sportit në nivel lokal dhe shtetëror -sukcese garuese në sistemet e ligave  
-punë me kategorinë e të rinjve  
-rekreacion

**3. Klasat - hapësirat që jepen për përdorim janë klasa**

-qëllimi i hapësirës - kurse në gjuhë të huaja për nxënësit  
-kohëzgjatja dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - në orë (60min) në një kohë të caktuar deri në 1(një) vit shkollor ,por nëse është e nevojshme për një periudhë më të gjatë apo më të shkurtë kohore .  
-Çmimi për shfrytëzimin e hapësirës 738,00 pa TVSH  
Kriteret për dhënien e shfrytëzimit të klasave , të cilat janë kusht për lidhjen e kontratës janë:  
-rezultate të rëndësishme të arritura në fushën e artit, letërsisë, muzikës dhe aktiviteteve të dramës ose nxitjen e nxënësve të talentuar për të zbuluar njohuri të reja.

**4. Hapësirë afariste - hapësirë që do të jepet për përdorim nga 100m2 në katin përdhese**  
-shfrytëzimi i hapësirës për zyrë kohëzgjatja dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - për një periudhë të kufizuar kohore deri në 1(një) vit shkollor, por nëse është e nevojshme për një periudhë më të gjatë apo të shkurtë kohore, në përputhje me nenin 13 të Vendimit të Këshillit të Komunës së Qendrës nr. 08-4089/42 nga 18.09.2018

-Çmimi i shfrytëzimit : 24.292,00 denarë pa TVSH , në muaj

**5. Hapësirë afariste - hapësira që do jepet në shfrytëzim e 200m2 hapësirë e bodrumit**

- qëllimi i hapësirës - depo hapësinore  
-kohëzgjatja dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - për një periudhë të kufizuar kohore deri në 1(një) vit shkollor , por , nëse është e nevojshme ,për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtë kohore , në përputhje me nenin 13 të Vendimit të Këshillit të Komunës së Qendrës nr. 08-4089/42 nga 18.09.2018.  
- çmimi i shfrytëzimit : 6.358,00 denarë pa TVSH , në muaj

**6. Shesh i sportit me barë**

-shfrytëzimi i hapësirës - sport dhe rekreativitet i fëmijëve dhe të rriturve  
-kohëzgjatja dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - për një periudhë të kufizuar kohore deri në 1(një) vit shkollor, por , nëse është e nevojshme , për një periudhë më të gjatë apo të shkurtë kohore .  
në pajtim me nenin 13 të Vendimit të Këshillit të Komunës së Qendrës nr. 08-4089/42 nga 18.09.2018.  
-çmimi i shfrytëzimit : 91.389,00 denarë pa TVSH në muaj  
Kriteret për dhënien e përdorimit të një fushe sportive , të cilat janë kusht për lidhjen e kontratës , janë :  
-kontribut në zhvillimin e sportit lokal dhe shtetëror -sukcese garuese në sistemet e ligave  
-punë me kategorinë e të rinjve  
-rekreacion

**7. Shesh sportiv - i betonuar**

-shfrytëzimi i hapësirës - sport dhe rekreacion i fëmijëve dhe të rriturve  
-kohëzgjatja dhe mënyra e përdorimit të hapësirës - për një periudhë të kufizuar kohore deri në 1(një) vit shkollor, por nëse është e nevojshme , për një periudhë më të gjatë apo të shkurtë kohore. Në pajtim me nenin 13 të Vendimit të Këshillit të Komunës së Qendrës nr. 08-4089/42 nga 18.09.2018  
-çmimi i shfrytëzimit : 55.916,00 pa TVSH , në muaj  
Kriteret për dhënien e përdorimit të një fushe sportive , të cilat janë kusht për lidhjen e kontratës janë :  
-kontribut në zhvillimin e sportit lokal dhe shtetëror -sukcese garuese në sistemet e ligave  
-punë me kategorinë e të rinjve  
-rekreacion

Qiramarrësi gjithashtu do të sigurojë përdorimin falas të shërbimeve për kategoritë e prekura sociale , në përputhje me nenin 12 të Vendimit të Këshillit të Komunës së Qendrës nr. . 08-4089/42 nga 18.09.2018.  
Shpallja është e hapur gjatë gjithë vitit .  
Ftohen të gjithë të interesuarit ofertues të dorëzojnë oferta sipas dokumentacionit të tenderit që mund të merret në shkollë, që nga data 09.10.2018, çdo ditë pune nga ora 9,00-14,00 .

SHF Dimitar Milladinov Shkup Qendër



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

**SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 196/2018**

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Mbrojtjes “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për patundshmëri, Sektori për patundshmëri 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat teknike - teknologjike ose shkencat matematiko natyrore
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përkshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 28.095,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMUNA E STRUGËS

SHESHI “NËNË TEREZA” P.N.,6330 STRUGË

Tel. +389 46 781 335, 781 223, 782 015, Faks 781 434

web: struga.gov.mk, e-mail: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

**Nr. 10-3496/4**  
**01.10.2018**  
**STRUGË**

Në bazë të nenit 24 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik /“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 51/05 137/07 91/09 124/10 18/11 53/11 144/12 55/13 163/13 dhe 42/14), dhe nenit 22 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale /“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 5/02/ dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 7 nga Statuti i komunës së Strugës “ Informatori zyrtar i komunës së Strugës “ nr. 17/02 , 30/02/, Kryetari i Komunës të Strugës, nëpërmjet mjeteve për informim publik dhe tabelës për shpallje, publikon:

**L A J M È R I M**

Për organizimin e Prezantimit publik dhe Anketës publike të përsëritur për Planin detal urbanistik për NJU 3, blloku 11, pjesa5,6 dhi 7– Komuna e Strugës, përfshirje midis rrugëve: në veri pjesë e rrugës „Dimçe Kovaçeski,, në lindje pjesë e rrugës „Gjuro Sallaj,, në jug rruga qasëshe 6, pjesë e rrugës „Na Lipite,, pjesë e rrugës „Velko Vllahoviq,, dhe në perëndim rruga qasëshe 1.

1. Lajmërohen të gjithë qytetarët e interesuar se do të zhvillohet Prezantimi publik dhe Anketa publike e përsëritur për Planin detal urbanistik për NJU 3, blloku 11, pjesa5,6 dhi 7– Komuna e Strugës, përfshirje midis rrugëve: në veri pjesë e rrugës „Dimçe Kovaçeski,, në lindje pjesë e rrugës „Gjuro Sallaj,, në jug rruga qasëshe 6, pjesë e rrugës „Na Lipite,, pjesë e rrugës „Velko Vllahoviq,, dhe në perëndim rruga qasëshe 1.

Anketa publike e përsëritur do të zgjasë 10-të ditë pune dhe atë në periudhën nga data 05.10.2018 deri në datë 19.10.2018.

Prezantimi publik i përsëritur do të mbahet në datë 19.10.2018 - hapësirat e Komunës së Strugës, me fillim në ora 12,30.

2. Plani detal urbanistik për NJU 3,blloku 11, pjesa 5, 6 dhe 7– Komuna e Strugës,do të paraqitet në korridorin e ndërtesës së vetëqeverisjes lokale të komunës së Strugës.

3. Qytetarët dhe personat juridik të interesuar, propozimet dhe vërejtjet e tyre mund ti dorëzojnë në fletat anketuese te organizatori i anketës, deri sa zgjat anketa publike.

4. Përpunuesi i planit detal urbanistik për NJU 3, blloku 11, pjesa5,6 dhi 7– Komuna e Strugës, do të sigurojë persona profesionistë për dhënien e sqarimeve gjatë mbajtjes së seancës së prezantimit publik dhe Anketës publike..

**KOMUNA E STRUGËS**  
**Kryetar i komunës,**  
**Dr. Ramis Merko**



KALAJA E TETOVËS NË GJENDJE TË MJERUESHME



# GËRMIMET NUK DO TË FILLOJNË

Përkundër premtimeve të shumta, nga viti 2008, Kalaja e Tetovës ka mbetur në gjendje të mjerueshme, pa asnjë përkujdesje dhe pa mbrojtje institucionale. Punimet e filluara dhjetë vite më parë, është dashur të përfundojnë në 2012

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 3 tetor - Ishte paraparë që të përfundojnë në vitin 2012 gërmimet arkeologjike në Kalanë e Tetovës. Të njëjtat kishin filluar në muajin gusht të vitit 2008, ku merrnin pjesë 13 arkeologë nga Kosova, Shqipëria dhe nga Maqedonia. Një pjesë e madhe e mureve rrethuese, kuzhinës dhe trapezarisë atë kohë ishin zbuluar nga gërmimet arkeologjike në Kalanë e Tetovës, të cilët ishin mbuluar nga dheu dhe mbeturinat. Megjithatë, sot e kësaj dite, Kalaja e Tetovës ka mbetur në këtë gjendje të mjerueshme, pa asnjë përkujdesje dhe pa mbrojtje institucionale. Vitin e kaluar kishte një premtim nga ana e ish-ministrit të Kulturës, Robert Allajgjozovski se pikërisht këtë vit (2018), do të rifillojnë gërmimet. "Disa mjete ishin paraparë të vazhdojnë punët deri në fund të këtij viti, por për shkak të rebalancit të buxhetit, janë paraparë mjete për vitin e ardhshëm, për shkak të stërngarkimit të buxhetit paraprak. Në çdo rast, punët në Kalanë e Tetovës do të vazhdojnë vitin e ardhshëm. Kjo tashmë është pjesë e prioritetëve të institucioneve përkatëse", kishte deklaruar vjet në Tetovë ish-ministri Allajgjozovski.

Por, nga ky premtim i dhënë nuk u realizua asgjë në terren. Në ndërkohë, ministri i Kulturës, Asaf Ademi, thotë se për këtë vit nuk janë paraparë mjete, ndërsa nuk dihet se a do të ketë mjete edhe për vitin e ardhshëm. "Për këtë vit nuk ishin paraparë mjete për të vazhduar gërmimet arkeologjike, në ndërkohë, kemi biseduar me përgjegjësit e institucioneve përkatëse që për vitin e ardhshëm të parashihen mjete për aktivitete në Kalanë e Tetovës", thotë Ademi. Kalaja e Tetovës është e ndërtuar në vitin 1830 dhe deri më sot, për shkak të mungesës financiare, nuk janë marrë masa për restaurim dhe gërmime më serioze. Në vitin 2008 ishin angazhuar mbi 200 punëtorë, ndërsa çdo sektor kishte udhëheqës in vet. Po ashtu, në gërmimet që filluan në vitin 2008 dhe nuk përfunduan asnjëherë, ishin angazhuar studentë të fakultetit të artit, arkitekturës, historisë dhe të tjerë. Gërmime arkeologjike ka patur edhe në vitin 1967, por të njëjtat nuk kanë zgjatur shumë. Krahas kësaj, në hyrje të Kalasë së Tetovës, disa vite më parë është shembur muri që njihet edhe si porta hyrëse e Kalasë së Tetovës. I njëjti vazhdon të qëndrojë në atë gjendje pa asnjë përkujdesje. Në vitin 2012, ish-drejtori i Drejtorisë për

Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, Pasko Kuzman, kishte deklaruar se mungesa e mjeteve kishte bërë që të mos intervenohet në muret hyrëse. "Ne para disa viteve bëmë konzervimi e disa pjesëve siç janë trapezeria dhe kuzhina e Kalasë, dhe për ato them se ato nuk do të shemben gjatë 150 viteve të ardhshme, ndërsa në këtë muret ku nuk ka pasur intervenime që nga ndërtimi i tyre para 300 viteve", tha Kuzman. Ai kishte deklaruar se para konzervimit të trapezerisë në vitin 2009, është bërë një hetim i tërë i Kalasë, ku është vërtetuar se të gjitha objektet duke përfshirë edhe muret me kullat kanë qenë në gjendje të njëjtë. "Vetëm mungesa e mjeteve ka pamundësuar mos intervenohet në kohë. Për fat të keq, ne nuk kemi fond rezervë me të cilin do të mund të kryejnë aktivitetet e nevojshme për këso raste të paplanifikuara", kishte thënë ai. Pikërisht ky është edhe prononcimi i fundit i Kuzmanit për Kalanë e Tetovës, i cili vet ishte përfshirë në gërmimet arkeologjike në Kalanë e Tetovës. Kalaja e Tetovës ndodhet, një në një lartësi mbidetare prej 803 metra, e lartë 220-250 metra dhe me sipërfaqe prej 108.000 metra katrorë.

## Dënohet thirrja për dhunë e Çilimanovit

Shkup, 3 tetor - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Pavarur dhe Punonjësve Mediatikë (SHPGM) dhe Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë (KEMM) e dënojnë thirrjen për dhunë të personit Cvetin Çilimanov, i punësuar si gazetar në Agjencinë Informativë të Maqedonisë, i cili, siç thonë, dje përmes Tuterit kërkoi nga taksistë maqedonas ta përdhunojnë gazetaren Valeri Hopkins kur do të hipë në automjetin e tyre sepse nuk i pëlqejnë tekstet e saj për gjendjen në Maqedoni. "SHGM, SHPGM dhe KEMM vlerësojnë se kanosjet e këtilla primitive nuk janë të orientuara vetëm kundër koleges Hopkins, por edhe drejt të gjithë komunitetit të gazetarëve dhe kanë për qëllim t'i frikësojnë gazetarët me qëllim që të mos i observojnë në mënyrë kritike proceset politike. Kanosje me përdhunim të Hopkinsit janë veti e ndërgjegjes totalitare nga ditët më të zeza të historisë evropiane, e cila përfshin edhe shfrytëzime dhe dhunë në ballafaqim me ata që nuk mendojnë njëjtë", thuhet në kumtesën nga SHGM, SHPGM dhe KEMM. E përkujtojmë Çilimanovin, shtohet, i cili njëherit është edhe nënkryetar i AGM dhe ishte anëtar i ad-hok komisionit të zgjedhjeve në vitin 2016, i propozuar nga ana e VMRO-DPM-NE-së, se thirrja e dhunës paraqet shkelje të rëndë të standardeve gazetareske dhe e prish solidaritetin gazetaresk. Me skandale të këtilla të pahijshme diskreditohet i gjithë komuniteti gazetaresk dhe gazetaria në përgjithësi si profesion, i cili duhet të kultivojë tolerancë dhe mirëkuptim të ndërsjellë. "Shtyrja e personave të tjerë të përdhunojnë një gazetare në asnjë rast nuk mund të konsiderohet si liri e shprehjes, por paraqet mohim të saj në formën më brutale të mundshme. Komunikimi i këtillë jo-shembullor me opinionin nuk posedon mbrojtje nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg dhe gjuhë të urrejtjes aprovon madje edhe sanksion me burg", potencohet në kumtesë.

## SHKATËRROHET NJË GRUP DILERËSH, GJASHTË TË ARRESTUAR

# Konfiskohen 22 kg mariuhanë nga Shqipëria

Shkup, 3 tetor - Gjashtë persona janë arrestuar dhe janë konfiskuar rreth 22 kilogramë mariuhanë në operacionin e së martës mbrëma të MPB-së, deklaroi zëdhënësi i Ministrisë, Toni Angellovski. Mariuhana ishte transportuar nga Shqipëria në Maqedoni. Në "Strazhë" nga ana e nëpunësve policor janë ndaluar dy automjete dhe gjatë kontrollit të realizuar në veturën "Shkoda superb" janë gjetur dhe konfiskuar dy thasë me mariuhanë. "Në vendin e ngjarjes nga liria janë privuar tre persona nga Shkupi, në mesin e të cilëve edhe organizatori i transportit të drogës K.R. (29) nga Shkupi, i cili para-



prakisht ishte dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 11 viteve dhe ishte në arrati nga Institucioni ndëshkues-përmirësues "Idrizovë", ndërsa ishte kërkuar pas shpalljes së urdhër arrestit. Të privuar nga liria janë edhe R.I. (23) dhe S.E. (22)", tha Angellovski. K.R. ka planifikuar ta shesë drogën në rajonin e Shkupit, Vele-

sit dhe Tetovës. Janë realizuar kontrole në Shkup dhe te R.I. është gjetur rreth 50 gramë kokainë, 16 pako me kokainë dhe një peshore digjitale, si dhe 46 plumba të kalibrit 22mm., përdërisa te S.E. ishin gjetur rreth 700 gramë mariuhanë dhe tableta ekstazë dhe një peshore digjitale. "Janë realizuar bastisje edhe në Strugë dhe Ohër, me ç'rast nga liria është privuar S.H.T. (36) i cili kishte blerë mariuhanën e konfiskuar nga Shqipëria, dhe gjithashtu në lidhje me këtë rast nga liria janë privuar edhe D.O. (62) nga Struga dhe A.I. (42) nga Ohri", tha ai. Janë konfiskuar edhe

dy automjete, rreth 3.000 euro dhe 4.000 denarë, para të cilat janë fituar nga shitja e drogës, ndërsa nga ana e MPB-së po ndërmerren masa dhe aktivitete për identifikimin e personave tjerë të përfshirë në këtë rast. Pas dokumentimit të plotë të ngjarjes, do të parashtrahet kallëzim penal deri te Prokuroria Publike Themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsion për veprë të bërë kriminale sipas nenit 215 paragrafi 3 "prodhimtari e palejuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike dhe substancave psikotrope. (O.Xh)



# Shiptarite se krivi (Shqiptarët kanë faj)



Nga  
Nazim RASHIDI

Në "Lagjen e Dibrës" ose "Debar Maallo" maqedonisht dhe siç njihet gjerësisht, ku është zemra e qytetit bohem, me lokalet e restorantet e vogla, prezenca shqiptare është shtuar dukshëm. Nuk përbën më çudi nëpër tavolina të flitet shqip, as për pronarët e as për klientët. Madje shumë biznese edhe të shqiptarëve, ndonëse jo me numër të madh, janë të vendosur në këtë lagje që është në qendër, por sërish disi e fshehur. Në këtë pjesë të qytetit penetron kryesisht pjesa më liberale e shoqërisë dhe dua të ndaj dy episode bisedash e konstatimesh që lidhen me periudhën para e pas referendumit për emrin. Arsyeja është e vetme, sepse po vij në një konstatim se shoqëria maqedonase nuk arrin dot të marrë përgjegjësitë e brezit të saj. Kur e them këtë nuk është se përgjashtohet edhe shoqëria jonë shqiptare, por referendumi dhe çështja e ndryshimit të emrit, që është disi më emocionale për maqedonasit e boldon këtë konstatim timin.

## EPISODI 1.

Në një nga kafenetë ku dielli i fundverës ende të shtynte të kërkosh hije, bënte që tavolinat të rrinë më pranë njëra tjetrës. Dhe biseda në tavolinën ngjitur shkonte kështu:

- Duhet votuar pro në referendum. Sepse në këtë mënyrë betonohen kufijtë e Maqedonisë dhe nuk do ju lejojmë shqiptarëve dominim. Por bashkëbiseduesi tjetër nuk u pajtua me këtë vlerësim. Duke dhënë argumente për atë se si grekët nuk duhet të përzihen dhe të tregojnë se kush si ndihet biseda vazhdoi nga tjetri në tavolinë, sigurisht me parafrazime, kështu:

- Po pikërisht për shqiptarët e kam. Nuk do ua lejmë atyre mundësinë që të na ndryshojnë emrin. Nuk mund që edhe ata të vendosin për emrin tonë.

Me përshkrimin e kësaj bisede dua vetëm të theksoj se mbytese ishte dhe si duket ende është fokusi tek shqiptarët duke mos lejuar që vetë maqedonasit të përballen me gjithë ato argumente se pse emri duhej të ndryshonte.

Sërish do ta theksoj, biseda bëhet në lagjen me urbane të vendit, ku presupozohet se mendjehapurit, që kanë parë

botën e që pushimet i bëjnë në Greqi në plazhet më të bukura, të mund të shihnin përparësitë e ndryshimit të emrit. Esenca e ndryshimit do ishte mes Republika Ish Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika Maqedonia e Veriut. Me emrin e dytë, pikërisht kjo shtresë e shoqërisë rrezik do shkonte të zhvendosej në Greqi, por kësaj here lirshëm, pa viza, dhe streset e kufijve. Biseda e tyre dhe argumentet do të duhej të ishin se çfarë fitohet dhe çfarë humbet. Qoftë edhe argumente se sa lëndohet e poshtërohet maqedonasi ose dhe jo. Por jo, kjo nuk shihej dot, sepse në qendër të debateve nuk ishte barra e vendimit të madh shoqëror, por argumentet pro dhe kundër marrëveshjes me shqiptarët në mes.

## EPISODI 2.

Në një kafene ku dielli i vjeshtës tashmë vazhdon të jetë prezent, e njerëzit duan të rrëmbejnë rreze por jo më nën hije, rrëmuja e krijuar në tarracat e lokaleve ku kërcasin syzet mes puthjesh të miqve të veshur me ngjyra vjeshte, temë diskutimi është referendumi, por tashmë pas rezultatit. Dhe

biseda në tavolinën ngjitur shkonte si vijon:

- Shqiptarët e kanë fajin. Nuk dolën sa duhet dhe me numrat që pritej. Si ka mundësi që të na e fusin kështu?

Këtë e tha bashkëbiseduesi i parë. Kurse i dyti që përpiquej të jetë më racional vijoi:

- Por nëse dilnin me një numër më të madh, do dilte se ata kanë bërë ndryshimin e emrit. S'do kish kuptim.

- S'do kishte rëndësi më vëlla, emri do kish ndryshuar, ne do ishim në NATO pastaj BE. Do kishite vetëm debate, ejjj... Gjithmonë ka diskutime pastaj... por puna do ishte kryer. Jo, jo. Shqiptarët na e futën. Ata e kanë fajin.

Seriozisht! Narracioni si para ashtu dhe pas referendumit lidhet me dhe rreth shqiptarëve. Por jo, kjo s'ka kuptim. Referendumi dështoi se një pjesë e madhe e maqedonasve nuk dolën të votojnë. Nëse duam të përdorim argumentin e suksesit ose jo për referendumin, qëndrimi duhet të jetë ky.

Dhe realisht, një numër i madh miqve, kolegëve, fqinjëve më kanë pyetur e shkruar se pse dështuan shqiptarët? Por kjo nuk

**Sa i përket shqiptarëve të mi, po duhej të dilnin me një numër më të madh në votim. E shkrova dhe javën që shkoi, po e them dhe tani, rreziku që votimi në referendum të shihej si dënim për klasën politike, tashmë u verifikua disi. Fushata e bërë më shumë partiake e jo si një arritje e një misioni e synimi prej dekadash e solli këtë moment**



është çështja thelbësore. Në Strumicën e Zoran Zaevit, nuk kishte shumicë votash pro pyetjes së referendumit!!! Pyetja do duhej të ishte si ka mundësi që ne si maqedonas nuk kuptuam rëndësinë e momentit historik? Por narracioni i tillë me shqiptarët në qendër nuk shtrohet vetëm në tavolina ku rrufiten kafetë e uiskit por edhe në media dhe qarqet akademike.

"Ishte e qartë se qeveria në Shkup vështirë se do të arrinte kufirin prej 50 përqind për tu arritur kushti i nevojshëm. Siç ishte e sigurt se votat "pro" do të ishin në përparësi.

(Dhe vini re tani) E vetmja befasia lidhet me mos suksesin e partive shqiptare që janë përfshirë në kabinetin e Zoran Zaevit..." Këtë e ka shkruar D-r Dimitar Beçev, deklarata e përcjellë me sa shoh edhe në mediet greke. Po maqedonasit që nuk dolën të votojnë? Po Qeveria që nuk arriti të bindë ata mbështetës të VMRO DPMNE-së që megjithatë të ngadhënjëjnë dhe të shohin se ardhmja e vendit do të jetë me e ndritur? Kjo si duket nuk ka rëndësi sepse ajo shtresë liberale maqedonase që sheh Evropën si prioritet duket se këtë

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 3 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



synim dëshiron ta arrijë me çdo kusht.

Por këtu nuk është kjo çështja. Për vendimin më të rëndësishëm historik pas pavarësisë së Maqedonisë, të gjithë duhej të kishin pasqyrë të qartë. Po është e vërtetë për mua se opozita maqedonase është oportuniste dhe nuk arrin, ose nuk do që ta shohë interesin e qytetarëve para të saj. Tragjike është se eksponentë të saj, jashtë kamerave, nën zë, apo dhe indirekt e pranojnë edhe e dinë se ku është e ardhmja dhe sa në fakt fitohet me këtë marrëveshje. Por nuk do ta pranojnë këtë.

Beteja e liberalëve, e shoqërisë maqedonase dhe jo vetëm, pra edhe e jona e shqiptarëve duhej të jetë me këtë qasje. Se kur vjen një moment, dhe momente të tilla në histori nuk shfaqen shpesh, retorika dhe banaliteti i politikës minore s'ka më rëndësi. Por këtë nuk e kuptuan maqedonasit përgjithësisht. Dhe më keq ende, këta liberalët dhe mendjehapurit maqedonas, reflektimin nuk e kanë me veten një herë, (përrash-time ka kuptohet) por edhe fajin edhe dëshpërimin edhe zgjidhjen e shohin përmes shqiptarëve. Sa do që të tingëllojë komplementuese për shqiptarët dhe rëndësinë e tyre, kjo është zhgënjyese për maqedonasit, sepse urban ose jo, pasion i tyre nuk duhet të jetë shqiptari. E ardhmja fillon me reflektimin mbi veten, do të thoshte Adelina Marku. Dhe kjo s'po bëhet. Normal është më lehtë ta gjesh fajin dhe justifikimin për situatën tek tjetri. Deri dje nuk ishim dot në NATO dhe BE për shkak të grekëve. Tani s'jemi dot në NATO e BE për shkak të shqiptarëve!

#### PËR SHQIPTARËT

Kurse sa i përket shqiptarëve të mi, po duhej të dilnin me një numër më të madh në votim. E shkrova dhe javën që shkoi, po e them dhe tani, rreziku që votimi në referendum të shihej si dënim për klasën politike, tashmë u verifikua disi. Fushata e bërë me shumë partiake e jo si një arritje e një misioni e synimi prej dekadash e solli këtë moment.

I qartë jam me analizat se numri i votave shqiptare janë aty sa edhe në zgjedhjet e tjera, por nuk do duhej të ishte rasti. Do të duhej që gjithë ai evropianizëm në retorikë, gjithë ajo mbështetje ndër vite e përdimit, gjithë ai mund kolektiv e shoqëror për idealin e përbashkët, të derdhej në një votë - vulë e të fuqishme pro rrugës drejt Brukselit, dhe jo thjeshtë si vota sa në zgjedhje të zakonshme. Se ky votim i zakonshëm nuk ishte.

Por kjo nuk ndodhi!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## Të "ribëjmë" Europën dhe t'i japim fund ndarjeve



Nga Christophe CASTANER, Olivier CHASTEL, Dacian CIOLOȘ, Joseph MUSCAT, Alexander PECHTOLD, Matteo RENZI, Albert RIVERA dhe Guy VERHOFSTADT

Në vitin 1918, Europa doli e shkatërruar nga një luftë të përgjakshme, që i la të hapura ndarjet e saj. Në vitin 1939, konflikti shpërtheu sërish, me rrenjë të saj tek fashizmi dhe një krizë ekonomike. U deshën dekada përpjekjesh dhe kompromisesh të vazhdueshme, që një brez të ri t'i ofronte më në fund Europës, atë që liderët që kishin shkuar symbyllurazi në dy luftëra, ia kishin mohuar: një Europë të paqes, prosperitetit dhe solidaritetit.

Një shekull më pas, tekta kontinenti ynë përballet sërish me përçarjen dhe stanjacionin ekonomik, ne nuk pranojmë të jemi një brez i ri të përgjumurish. Ne duhet të veprojmë tani, ose projekti evropian do të ndalet. Më keq, ai mund të uzurpohet nga forcat nacionaliste dhe populiste, për të cilat BE-ja përfaqëson një anomali historike, që duhet të zhbëhet. Kur kanë mbetur edhe 8 muaj nga zgjedhjet për në Parlamentin Evropian, ne po bëjmë një apel: ta "rishpikim" Europën, që më në fund ajo të të përmbushë pritshmërinë e qytetarëve të saj, dhe të rimarrë premtimin e saj original. Europa në këtë moment duket shumë e mbingarkuar nga sfidat: ekologjike,

Kemi edhe 8 muaj kohë për të bindur qytetarët e vendeve tona, se Europa e meriton këtë projekt të ri, dhe se qytetarët e meritojnë këtë Europë të re. Koha po mbaron: ne kemi vetëm 8 muaj kohë për të zgjuar Europën



ekonomike ose ato të lidhura me emigracionin.

Ajo është e mbingarkuar nga pritshmëria e qytetarëve për më pak rregullime dhe më shumë veprime konkrete. Ajo është e mbingarkuar nga angazhimet që nuk mund t'i mbajë dot më, pasi i mungon vizioni i përbashkët dhe efektiviteti në funksionimin e tij. Megjithatë, premtimi i Europës nuk është i humbur; thjeshtë ka rënë në "gjumë".

Progresi i fundit tek rregullat për punëtorët emigrantë, dhe politikën e mbrojtjes tregon se Europa bën përparim kur vullneti politik, i tubon evropianët rreth një projekti të qartë dhe ambicioz. Dhe kur është fjala për tatinin e ekonomisë digjitale, ne vetëm sa kemi filluar, por e dimë se një zgjidhje mbarë-europiane

është e vetmja rrugë. Fjalimi i presidentit francez Emanuel Makron në Sorbonë, e mishëron këtë ambicie: tani na takon neve që ta bëjmë atë realitet. Nuk është thjeshtë një çështje e tejkallimit të ndarjeve, që kanë çuar në ngërçin aktual. As edhe një çështje për të kujtuar vazhdimisht, se njerëz si Orbanët, Lë Penët dhe Salvinët e Europës, nuk kanë asgjë për të ofruar përtej fajësisë së BE-së për të gjitha të këqijta e tyre. Ne duhet të ofrojmë zgjidhje. Ja pse plani ynë për të rishpikur Europën është i qartë: Në vend që të angazhohemi me kërcënime të tilla si "spastrimi masiv" i përmendur nga Mateo Salvini në Itali, "heqja qafe e Islamit" nga AfD në Gjermani ose "dhënia fund e Europës" nga Marin Lë Pen, ne shpallim me krenari vlerat themelore të paqes, lirisë, prosperitetit dhe solidaritetit.

Në vend se të mbështesim thirrjet për të goditur sistemin e drejtësisë dhe opozitën politike, ne kërkojmë respekt të rreptë për sundimin e ligjit, dhe për institucionet demokratike. Në vend se të pranojmë që një kontinent i ndarë dhe i dobësuar, të mbetet në mëshirën e fuqive të tjera të mëdha në botë, ne po bëjmë thirrje për një Europë sovranë, të aftë për të vepruar me forcë në fushat ku shtetet anëtare janë të pafuqishme, në politikën ekonomike dhe monetare, në sigurinë dhe mbrojtjen, mjedisin dhe bujqësisë, politikën sociale, emigracionin, integrimin dhe revolucionin digjital. Kjo është edhe arsyeja se pse metoda jonë është e qartë: në vendosmërinë tonë për

të rishpikur Europën, nuk është e përjashtuar asgjë. Ne jemi të gatshëm të reformojmë traktatet e BE-së nëse është e nevojshme. Jemi të vendosur të ecim përpara pavarësisht pengesave, duke pruar se çdo vend duhet të ecë përpara me ritmin e vet. Ne duam një Europë më të fortë, dhe ne do të qëndrojmë të hapur për ata që duan të bashkohen rrugës me ne. Ne jemi të vendosur të shkojmë përtej strukturave ekzistuese partizane, nëse ato veprojnë si pengesa. Ne jemi të përkushtuar për ta rishpikur Europën së bashku, me burrat dhe gratë që udhëhiqen nga vendet e tyre, nga veriu dhe jugu, nga perëndimi dhe nga lindja, të cilët janë të apasionuar për Europën, dhe të vendosur për të investuar në këtë projekt historik, ndërsa të tjerët janë të kënaqur të recitojnë mallkime ndaj tij.

Tani kemi 8 muaj kohë për të bindur qytetarët e vendeve tona, se Europa e meriton këtë projekt të ri, dhe se qytetarët e meritojnë këtë Europë të re. Koha po mbaron: ne kemi vetëm 8 muaj kohë për të zgjuar Europën.

(The Guardian)



Shënim: Christophe Castaner, president i "Republika në Marshim" në Francë; Olivie Shastel, kryetar i Lëvizjes Reformatore në Belgjikë; Dacian Ciolos ish-kryeministër i Rumanisë; Josef Muskat, kryeministër i Maltës; Aleksandër Pehtold, kreu i Partisë Demokratike 66 në Holandë; Mateo Renci, ish-kryeministër i Italisë; Albert Rivera, udhëheqës i Ciudadanos, Spanjë; Gi Verhofstad, është president i Grupit ALDE në Parlamentin Evropian, dhe ish-kryeministër i Belgjikës.





## Ariu rus që u kthye në ikonë Instagrami

Stepan është emri i ariut që është rritur nga një çift rusësh e që tashmë ka marrë famë edhe në Instagram. Kur çifti del me ariun 24 vjeçar, duken si një familje normale që shëtisin, hanë ushqim e bëjnë lojëra bashkë. Çifti thotë që ata e gjetën Stepanin kur ishte tre muajsh, dhe sot ai ha 25 kg ushqim në ditë, që përfshin peshk, fruta e perime të ndryshme. Për të mbajtur trupin në formë i pëlqen të luajë futboll. Ariu ka marrë pjesë në një film kanadez, ku kishte rol kryesor. Tashmë, përveçse ofron foto për njerëzit në Instagram, mund të vijë edhe në festa të ndryshme për rreth 2000 dollarë.







## AEROPORTI MË I MIRË NË BOTË.

**Përfshin kinema, kopsht botanik, jacuzzi dhe kënd lojërash**

Aeroporti Changi i Singaporit u shpall këtë vit për të gjashtin vit radhazi si aeroporti më i mirë në botë, një çmimi i dhënë nga portali i vlerësimit Skytrax.


Arsyet për dhënien e çmimit bëhen shumë të qarta sapo kontrollon një listë të shërbimeve shtesë që ai afron.

Si fillim, për ata që duhet të presin një kohë të gjatë deri në fluturimin e tyre, ka salla kinemaje që shfaqin pa pagesë filmat më të fundit. Ndërsa për udhëtarët që duan të nisin pushimet e tyre pak më herët, apo duan ta bëjnë një udhëtim biznesi të duket si udhëtim argëtimit, aeroporti u ofron një pishinë në katin e fundit, me jacuzzi dhe një bar.

Sikur të mos mjaftonin këto, aeroporti është i mbushur me kopshte botanike, të cilat kanë bimë si luledielli, orkide, kaktus, por edhe flutura dhe një pellg me peshq të kuq.

Njerëzit që e duan argëtimin, por sidomos fëmijët shijojnë këndin e lojërave pesëkatësh dhe rrëshqitëset gjigande. Në brendësi të tij, në hapësirën tregtare, aeroporti ka dyqane duty-free me dizajn dhe arredim fantastik.

Krahas këtyre elementëve, udhëtarët do të vlerësojnë mbi të gjitha pastërtinë, shërbimin e shkëlqyer ndaj klientëve, si dhe vendet e rehatshme për të pushuar.







## Rriten aplikimet për t'u punësuar jashtë Kosovës

Mesatarisht 65 qytetarë në ditë u drejtohen kompanive që merren me përgatitjen e stafeve profesionale për punë jashtë vendit. Numri më i madh i kërkesave bëhet për sektorët e sistemit mjekësor, por kohëve të fundit nga kërkesa e madhe për punë fizike ka nisur edhe aftësimi për këtë sektor. Drejtori i kompanisë, Musa Ahmeti, tregon se kërkesat për punë fizike kanë kaluar pritshmërinë. Ahmeti tregon se kërkesat këtë vit janë rritur për 7 mijë qytetarë më shumë se sa në vitin e kaluar. Numri më i madh i të interesuarve janë studentë. Me këtë problem po përballen edhe kompanitë nga industria e drurit. Ata thonë se si pasojë e mirëqenies së ulët në vend nuk po mund të ofrojnë kushte pune siç i ofrojnë vendet e BE-së. Këtë hendek të sektorit privat, sipas Arian Zekës nga Oda Amerikane e Kosovës, po e krijon qeveria me rritjen e pagave vetëm në sektorin publik. E, zgjidhja sipas Zekës është rritja e investimeve të huaja në vend. Në anketën e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës doli se në vend janë 24 mijë qytetarë që e kanë lëshuar punën vetëm për një vit.

# VUÇIÇ I GATSHËM TË NJOHË PAVARËSINË E KOSOVËS, PËR INTEGRIMIN E SERBISË NË BE

Russia Today shkruan në një artikull se presidenti serb, Aleksandar Vuçiç është i gatshëm të njohë Pavarësinë e Kosovës, në këmbim të anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin European.

Katër ditë pasi urdhëroi ushtrinë serbe të vendosë gatishtë luftarake, presidenti serb Aleksandar Vuçiç po viziton Moskën, ku është takuar me homologun e tij rus Vladimir Putin. Ndërsa Vuçiç tha se situata e krijuar në veri të Kosovës pas "ndërhyrjes" së Policisë së Kosovës do të ishte pjesë e diskutimit me Putinin, Kremlini theksoi se vizita ishte planifikuar muaj më parë dhe kjo vizitë nuk lidhet drejtpërdrejt me tensionet në Ballkan.

Vuçiç e vizitoi Rusinë në maj të këtij viti kur Rusia festonte "Ditën e Fitores". "Russia Today", shkruan se të shtunën e kaluar dhjetëra tru-



pa kosovare kishin hyrë në një enklavë serbe në veri të Kosovës, duke marrë nën kontroll disa vende industriale. Kjo ndërhyrje e Prishtinës, sipas Russia Today, kishte shkelur marrëveshjet e arritura mes Prishtinës dhe Beogradit.

Serbia kishte reaguar duke vënë ushtrinë në gjendje lufte. Sipas analistit serb të kësaj medie, Aleksandar Pavić, situata tashmë është qetësuar, por jo edhe potenciali për dhunë që ekziston në ato terriore. Sipas këtij analisti Vuçiç ka pak mbështetje në Serbi për t'u pajtuar me Kosovën për ndonjë marrëveshje të mundshme.

Edhe Rusia i ka bërë të qartë Vuçiçit se nuk do të mbështesë ndonjë marrëveshje të mundshme me Kosovën, nëse marrëveshja nuk ka mbështetjen e popullit serb. "Serbia do të ketë përçarje të brendshme, sepse shumica e opinionit serb është kundër ndarjes", tha Pavić. "Kjo është një çështje shumë delikate si për presidentin serb edhe për presidentin rus", tha ai.

Gjithashtu, analisti shtoi se nëse Kosova njihet si një shtet sovran nga Serbia, rezultati i mundshëm do të ishte që Kosova të bëhet pjesë e Shqipërisë, një anë-

tare e NATO-s dhe Moskës e shihet NATO-n si një armike të Rusisë. Pavel Kandel, një ekspert për konfliktet etnike në Institutin e Akademisë Ruse të Shkencave, tha se tensionet janë produkt i dobësisë së pozitave të dy liderëve.

"Thaçi, pozita e të cilit në Kosovë është dobësuar, me të vërtetë duhet të tregonte se sa i ashpër është, se si ai është në gjendje të kontrollojë situatën atje dhe madje mund të udhëtojë në veri të Kosovës bashkë me forcat e armatosura. E njëjta gjë vlen edhe për Vuçiçin dhe për grumbullimin e ushtrisë së tij. Ai duhet të tregonte se ishte gjithashtu një lider i ashpër", i tha ai "Russia Today".

Kandel tha se Vuçiç është i gatshëm ta pranojë Kosovën nëse Serbia futet në BE.

"Unë besoj se Vuçiç do të jetë i gatshëm të njohë pavarësinë e Kosovës në këmbim të anëtarësimit të Serbisë në BE. Por, shqiptarët [në Kosovë] nuk janë të gatshëm të pranojnë asnjë kompromis për të shpëtuar fytyrën e Vuçiçit", përfundoi ai.

## Kommersant: Vuçiç nuk e mori miratimin e Putinit për njohjen e Kosovës, pa veriun e saj

Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç në bisedime me presidentin rus Vladimir Putin nuk ka arritur qëllimet e paralajmëruara në prag të vizitës, respektivisht, nuk ka marrë "miratimin për versionin e tij të njohjes së Kosovës", shkruan e përditshmja e Moskës "Kommersant", transmeton zeri.info

Gazeta thekson se presidenti serb shpesh vjen në Rusi, "më shpesh se çdo president tjetër", duke shtuar se Putin është mjaft popullor në Ballkan dhe për presidentin serb ardhja e serishme në Moskë do të thotë një rritje në popullaritet për një përqindje të vogël.

Kommersant shkruan se përpara mbërritjes Vuçiçit në Moskë ka ndodhur një 'situatë e pakëndshme' me paraqitjen e kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçi në veri të Kosovës.

"Vuçiç donte për të tërhequr vëmendjen e Putinit për shqetësimin në lidhje me këtë situatë, pasi që, sipas informacionit nga Kommersant, në Serbi presin për seancën e Këshillit të Sigurimit, ku Kina do të ngrejë çështjen e njohjes përfundimtare të Kosovës nga Organizata Ndërkombëtare ... dhe Vuçiç nuk është kundër kësaj, veçanërisht për shkak se ai e ndjen presionin e udhëheqjes së BE-së

dhe Federica Mogherinit: është e mundur që ai dëshiron të kujtohet për funksionin e tij si dikush që më në fund për botën e mbylli çështjen e Kosovës", shkruan gazeta në fjalë, dhe shton se Vuçiç "gjatë bisedimeve me Putinin ka kërkuar për të fituar mbështetjen e tij për njohjen e Kosovës" dhe se presidenti serb është i përgatitur për njohje të tillë, në qoftë se ndahet veri i Kosovës, përcjell zeri.info.

"Prandaj Vuçiç fuqishëm i premtoi Rusisë se Serbia nuk do të bashkohet me NATO-n? Por, në rast të tilla ndodh që për të gjitha që je betuar se nuk i bënë, në fund ndodh e kundërta", shkruan Kom-

mersant.

"Është e qartë se negociatorët rusë e kuptuan se nuk është aq mënyrë e thjeshtë për të biseduar me Vuçiçin. Në fillim ishte vetëm Putini, negociatat sy me sy kanë zgjatur më shumë se një orë dhe për 40 minuta temë ishte Kosova", shkruan tutje gazeta ruse. Gazeta shton, duke cituar disa burime se Vuçiç "nuk hasi në mirëkuptim të Putinit se pse Rusia nuk ka nevojë për të vënë veton në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, nëse Kina shtron çështjen e anëtarësimit të Kosovës në OKB dhe çmimin e kësaj për Serbinë sipas variantit të Vuçiçit".

## Shqipëria emeton Eurobondin 500 milionë euro

Shqipëria ka mbyllur daljen e saj të tretë në tregjet e kapitalit duke emetuar një Eurobond me vlerë 500 milionë euro me kupon fiks 3.55 për qind. Për herë të parë eurobondi ka një afat 7 vjeçar nga 5 vjeçar që ka qenë në dy emetimet e mëparshme ndërkohë që interesi i investitorëve ka qenë i lartë me një ofertë 1.25 miliardë euro çka do të thotë se ka pasur një raport mbulimi me 2.5 herë. Ajo që vihet re në këtë dalje të fundit në tregje është interesi dukshëm më i leverdshëm krahasuar me

2015-wn ku kuponin fiks ishte 5.75 për qind.

Ashtu sikurse ka deklaruar, qeveria ka përdorur për shlyerje të menjëhershme të vlerës së mbetur të eurobondit të 2015-ës, 200 milionë euro. Sot ky borxh u është blerë investitorëve me 109.75% çka konsiderohet si një fitim i leverdshëm për të gjithë ata që investuan dikur në borxhin e Shqipërisë. Ndërkohë që pjesa prej 300 milionë euro e mbetur nga Eurobondi i ri i shtohen stokut si një borxh i ri dhe që sipas argumenteve që janë dhëna më herët nga qeveria

do të shkojnë si mbështetje buxhetore.

Në këtë transaksion Shqipëria u asistua nga Banca IMI, Citi (B&D), Societe Generale.

Ashtu sikurse pritej Shqipëria ka debutuar më mirë se çdo herë në tregjet e kapitalit në emetimin e fundit por në krahasim me fqinjët tonë Maqedoninë sërish jemi më pak të preferuar. Maqedonia doli në tregje më herët gjatë këtij viti për një Eurobond me vlerë 500 milionë euro dhe me një afat maturimi prej 7 vitesh pra të njëjtat kërkesa si Shqipëria por rapor-



ti i mbulimit për këtë kërkesë ishte 7 herë më i lartë. Investitorët i ofruan fqinjit tonë 3.5 miliardë euro dhe më një interes më të leverdshëm se Shqipëria prej 2.75 për qind te kuponit fiks çka është e

kuptueshme në kushtet kur renditja nga agjencitë e vlerësimit të riskut është më pozitive ndërkohë që daljet e saj në tregjet e kapitalit janë edhe më të shumta sesa Shqipëria. (MONITOR)



# ZARFE ME HELM VDEKJEPRURËS KANË MBËRRITUR NË PENTAGON



thënë se zarfi i dyshimtë është dërguar te Trumpi një ditë më parë, mirëpo nuk është pranuar nga Shtëpia e Bardhë.

Agjencia nuk ka bërë të ditura detajet rreth asaj se çfarë ka pasur në zarf.

Autoritetet në Pentagon kanë thënë se janë duke bërë hetime për dy letrat që dyshohet se kanë pasur përmbajtje të agjentit vdekjeprurës, ricin.

Letrat janë dërguar në FBI për analiza të mëtejme. Ricini është agjent tejet i ashpër, pasi vetëm sasi shumë e vogël e tij mund të shkaktojë vdekje brenda 72 orëve.

sur drejt shefave të lartë ushtarakë, por edhe për një letër të tretë e cila ka pasur përmbajtje të panjohur deri më tani të nisur

drejt presidentit amerikan, Donald Trump.

Në një deklaratë të publikuar më 2 tetor, Shërbimi Sekret ka



## Turqia dënon 6 gazetarë me burgim të përjetshëm

Cjykata në Turqi ka konfirmuar dënimet me burg të përjetshme për 6 gazetar, pasi janë dënuar për ndihme në planifikimin e grushtetit të dështuar në këtë vend, transmeton "Zëri.Info".

Ahmet Altan, vëllai i tij Mehmet Altan dhe katër gazetar tjerë kohe më parë ishin dënuar me burgim të përjetshëm për shkak të lidhjes së dyshuar me rrjetin e imamit mysliman Fetulah Gulen të cilin Turqia e akuzon për organizimin e grushtetit të dështuar në këtë vend. Mehmet Altan në qershor ishte liruar nga burgju, por sot edhe atij i është shqiptuar dënimi, pasi gjykata penale e ka hedhur poshtë kërkesën e Gjykatës Kushtetuese për lirim të tij.

Reuters shkruan se të gjashtë gazetarët tani do t'i vuajnë dënimet me të ashpra me burgim të përjetshëm, çka nënkupton se nuk kanë të drejtë për lirim me kusht dhe se për ta nuk do të vlejnjë vendimet e ardhshme për amnistinë.

SHBA- Dy zarfa, njëri drejtuar sekretarit të Mbrojtjes Jim Mattis, i cili po udhëton në Evropë këtë javë dhe tjetri drejtuar oficerit më të lartë të Marinës, Admiral John Richardson kanë mbërritur në Pentagon.

Zarfet kishin brenda tyre përmbajtje ricine, helm që nxirret nga kastori dhe që është gjërësisht shumë i përdorur nga terroristët. Ricina mund të shkaktojë vdekjen brenda 36-72 orësh nga ekspozimi ndaj një sasive mjaft të vogël, sa një majë gjilpëre dhe kundër saj nuk ekziston ndonjë lloj antidote.

Sipas Departamentit të Zjarrfikësve në Houston, dy persona u dërguan në spital pasi ishin ekspozuar ndaj substancës helmuese.

Autoritetet amerikane janë duke bërë kërkime për dy raste të letrave që dyshohet se kanë qenë të helmuara me ricin dhe janë ni-

## SHBA: Po shqyrtojmë shkatërrimin e një sistemi raketor rus

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në NATO, Kay Bailey Hutchison, ka thënë se nëse është e nevojshme, SHBA do të shqyrtojë shkatërrimin e një sistemi raketor të Rusisë, që Uashingtoni beson se Moskë po e zhvillon duke shkelur një traktat të armëve bërthamore.

Duke folur për gazetarët në Bruksel, ambasadorja i bëri thirrje Rusisë që të ndalë zhvillimin e sistemit 9M729, i cili, sipas SHBA-ve, shkel Traktatin e Forcave Bërthamore me rreze të mesme, të vitit 1987.

"Është koha për Rusinë që të vijë në tryezën e bisedimeve dhe t'i



ndalojë shkeljet", ka thënë Hutchison.

Nëse sistemi "është i gatshëm për përdorim", ajo ka thënë se Shtetet e Bashkuara "do të shqyrtojnë kapacitetet për t'iu kundërvënë

raketës e cila mund të godasë Evropën apo Amerikën".

Rusia në anën tjetër ka mohuar ndonjë shkelje të traktatit, i cili ndalon raketat me rreze nga 500 deri në 5,500 kilometra. /REL



## Shuma marramendëse që i ati i la Donald Trump-it kur ishte 3 vjeç

Presidenti aktual i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka lindur i pasur. Ai ishte miliardër që në vitet e para të jetës së tij, sipas New York Times. Që në moshën 3-vjeçare ai fitonte 200 mijë dollarë në vit, e po ashtu i ati i la një pasuri prej 413 milionë dollarësh. Kjo ishte vetëm në vitet e para, por pasi mbaroi kolegjin, i ati i jepte rreth 1 milionë dollarë në vit. Pasuria e akumuluar e Donald Trump ka ardhur duke u rritur me kalimin e viteve. Megjithatë sulmet ndaj Trump lidhur me pasurinë e tij kanë qenë të shumta. Madje së fundmi ai akuzohet edhe për mos pagesë taksash për disa biznese të tij. Por, Shtëpia e Bardhë i ka hedhur poshtë këto akuzë duke i quajtur sulme politike e të papërshtatshme.

## Gjermania kërkon punëtorë të kualifikuar

Në Gjermani, koalicioni qeverisës arriti një marrëveshje në fund të negociatave të gjata mbi ligjin e ri të emigracionit. Cdu-Csu dhe Spd kanë arritur në një kompromis mbi legjislacionin që synon të tërheqë fuqi punëtoreshë të kualifikuar nga vende jashtë Bashkimit Evropian. Në parim, ekziston një ndarje midis azilit dhe emigracionit ekonomik, një pikë që është diskutuar gjatë natës gjatë hartimit të dokumentit.

Kërkesat – "Emigrantët nga vendet jashtë Bashkimit Evropian do të kenë 6 muaj për të kërkuar



punë në Gjermani", tha Ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer, gjatë një konference shtypi. Për të gjetur një punë, do të jetë thelbësore që të keni një

njohuri të mirë të gjuhës gjermane dhe një trajnim adekuat për llojin e punës që kërkoni.

Ulje e emigracionit të paligjshëm – "Në përgjithësi, kemi arri-

tur një marrëveshje për të menaxhuar më mirë emigracionin e fuqisë punëtore të kualifikuar, – vazhdoi Seehofer, – siç ishte në marrëveshjet e koalicionit dhe unë jam shumë i lumtur me atë që është rënë dakord. Kemi nevojë për forca të kualifikuar nga shtetet e treta dhe emigrimi i paligjshëm mund të reduktohet nga këto masa".

Përveç vizave të përkohshme prej gjashtë muajsh për të kërkuar punë, janë premtuar procedura më të shpejta për njohjen e kualifikimeve.

## Qeveria gjermane me plan të ri për makinat e vjetra me naftë

Partnerët e koalicionit në qeverinë gjermane u pajtuan që pronarët e automjeteve më të vjetra me naftë, në qytetet ku ajri është veçanërisht i ndotur, t'iu ofrohet mundësi për të zgjedhur në mes stimujve për blerjen "i vjetër për të ri" dhe përmirësimet në harduer për kontrollin e emetimeve.

Pas bisedimeve maratonike në fund të natës, kancelarja Angela Merkel dhe liderët e partnerëve të

saj të koalicionit njoftoi herët këtë mëngjes se ata kishin rënë dakord për të ulur nivelin e ndotjes në qytete, duke shmangur masat jopopullore për ndalimin e vozitjes.

Edhe pse qeveria në informacionin e parë nuk ka dhënë detaje të marrëveshjes, Reuters shkruan se prodhuesit gjermanë të veturave kanë rënë dakord për të ofruar programin "i vjetër për të ri" me stimuj atraktivë ose lirime për pro-

narët e automjeteve me naftë me emisionet standarde Euro 4 dhe Euro 5. Nëse pronarët e Euro 5 duan për të përmirësuar harduerin për të ashtuquajturin reduktim selektiv katalitik (SCR) dhe nëse ai është në dispozicion dhe kuptimplotë, qeveria gjermane pret që prodhuesit të marrin përsipër këto shpenzime. Kostot e përmirësimit të pajisjeve me sisteme SCR për automjetet e shpërndarjes dhe fur-



gona komerciale do të subvencionohen nga qeveria deri në 80 për qind. Sipas të dhënave zyrtare, Gjermania ka 3.1 milionë makina

me standardin Euro 4 dhe 5.7 milionë me Euro 5 me motorë dizel, nga gjithsej 46.5 milionë makina në rrugët gjermane.





UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" - SHKUP  
УНИВЕРЗИТЕТ "МАЈКА ТЕРЕЗА" - СКОПЈЕ  
"MOTHER TERESA" UNIVERSITY - SKOPJE

### KONKURS PËR PUNËSIM NË UNIVERSITETIN "NËNË TEREZA" NË SHKUP

Në bazë të nenit 160 paragrafi (3) të Ligjit për Arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 82/18), ndërsa lidhur me nenin 6 dhe nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), dhe nenit 22 paragrafi (1) alineja 1, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/2016 dhe 120/18) Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup shpall

#### KONKURS PUBLIK

për punësim të 31 (tridhjetë e një) personave në kohë të pacaktuar edhe atë:

#### 1. UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR MËSIM TË PËRJETSHËM – (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, shkencave ekonomike dhe shkencave të mjekësisë dhe shëndetit**
- Së paku **pesë vjet** përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku **dy vite** në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku **tetë vite** përvojë pune në profesion prej të cilave së paku **tre vite** në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 35.854 denarë

#### 2. SEKRETAR I FAKULTETIT TË NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS ----- (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Së paku tre përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 25.006 denarë

#### 11. KËSHILLTAR PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS DHE TË NDËRMARRËSISË – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Së paku tre përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 25.006 denarë

#### 12. BASHKËPUNËTOR I LARTË PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 23.400 denarë

#### 13. BASHKËPUNËTOR I RI PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE NORMATIVO JURIDIKE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 14. BASHKËPUNËTOR I RI PËR BURIMET NJERZORE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit, Shkencave ekonomike;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 15. BASHKËPUNËTOR I RI PËR PROTOKOL DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave politike, Shkencave organizative dhe menaxhimit, Administrata publike dhe menaxhimi publik;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 25.006 denarë

#### 10. KËSHILLTAR PËR SIGURIM TË CILËSISË – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të

fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Kontrollimi i cilësisë;**

- Së paku tre përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 25.006 denarë

#### 11. KËSHILLTAR PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS DHE TË NDËRMARRËSISË – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Së paku tre përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 25.006 denarë

#### 12. BASHKËPUNËTOR I RI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 23.400 denarë

#### 13. BASHKËPUNËTOR I RI PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE NORMATIVO JURIDIKE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 23.400 denarë

#### 14. BASHKËPUNËTOR I RI PËR BURIMET NJERZORE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Administrata publike dhe menaxhimi publik, Shkencave organizative dhe menaxhimit;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 15. BASHKËPUNËTOR I RI PËR PROTOKOL DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave politike, Shkencave organizative dhe menaxhimit, Administrata publike dhe menaxhimi publik;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 16. BASHKËPUNËTOR I RI PËR TIK – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Informatikës, teknikës kompjuterike dhe informatikës, elektroteknikës;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 13.148 denarë

- Me ose pa përvojë pune në profesion;

- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 17. BASHKËPUNËTOR I RI PËR ÇËSHTJE STUDENTORE DHE BASHKËPUNIM ME FAKULTETIN E SHKENCAVE TË INFORMATIKËS – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Teknikës kompjuterike dhe informatikës, Shkencave organizative dhe menaxhimit, Informatikë;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 18. BASHKËPUNËTOR I RI PËR ARSIM DHE SHKENCË – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave të gjuhës (linguistikë); psikologjisë, edukimit;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 19. BASHKËPUNËTOR I RI PËR ÇËSHTJE STUDENTORE DHE BASHKËPUNIM ME FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Edukimit, Shkencave organizative dhe menaxhimit, makinerisë;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 20. BASHKËPUNËTOR I RI PËR ÇËSHTJE STUDENTORE DHE BASHKËPUNIM ME FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave juridike, Edukimit, Administrata publike dhe menaxhimi publik;**
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 20.969 denarë

#### 21. REFERENT I PAVARUR PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE – (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Arsim të mesëm
- Së paku tre vjet përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 15.671 denarë

#### 22. REFERENT I RI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE, ÇËSHTJE STUDENTORE DHE BASHKËPUNIM ME FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE – (2) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Arsim të mesëm
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 13.148 denarë

- Me ose pa përvojë pune në profesion;

- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 13.148 denarë

#### 23. REFERENT I RI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE, ÇËSHTJE STUDENTORE DHE BASHKËPUNIM ME FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE – (2) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Arsim të mesëm
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 13.148 denarë

#### 24. LABORANT NË LABORATORIUMIN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE --- (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e **Shkencave teknike** ----- (1) përmbarues
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 28 deri më 28 duhet t'i plotësojnë kushtet e posaçme të mëposhtme

- arsim të mesëm
- Me ose pa përvojë pune në profesion;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge);

Paga neto do të arrin deri në 13.148 denarë

#### 28. SHOFRER – (1) përmbarues

Kandidatët për vendet e punës prej 29 deri më 30 duhet t'i plotësojnë kushtet e posaçme të mëposhtme:

- Arsim të mesëm
- me ose pa përvojë pune në profesion
- posedimi i lejes së vozitjes, kategoria B
- Paga neto do të arrin deri në 13.148 denarë
- Kandidatët përveç kushteve të lartpërmendura, duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme në vijim:
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive ta njeh (përdorë) gjuhën maqedonase;
- Të jenë të moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim nga gjykata se nuk ka të shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për të aplikuar.

**Kandidatët së bashku me fletëaplikimin duhet të dorëzojnë edhe dëshmitë se i plotësojnë kushtet, në formë origjinale ose të vërtetuara nga noteri, edhe atë:**

1. Dëshmi mbi shtetësinë e Republikës së Maqedonisë
2. Vërtetim për shëndetin e përgjithshëm për vendin e punës – Vërtetim mjekësor
3. Vërtetim nga gjykata se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
4. Certifikata / Diploma për nivelin e kryer arsimor në përputhje me kërkesat në konkurs;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës;
6. Dëshmi për kryerje të punëve në nivel udhëheqës (vetëm për pozitë udhëheqëse – numrat rendor 1 dhe 2);
7. Dëshmi për njohje të gjuhëve të huaja në përputhje me kërkesat në konkurs;
8. Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
9. Për vendin e punës me numër rendor 02, Dëshmi për dhënie e provimit për auditor i brendshëm zyrtar ose Certifikatë të pranuar ndërkombëtare për auditor.

**Orari i punës:** 40 orë në javë, prej 08:30 deri 16:30 gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premten.

Me kandidatit e përzgjedhur do të firmoset kontrata e punës me kohëzgjatje të pacaktuar.

Afati për dorëzimin e fletëaplikimeve me dokumentet e kërkuara do të zgjasë **5 ditë pune** nga dita shpalljes së konkursit (duke përjashtuar ditën e shpalljes).

Kushtet e përcaktuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Nëse në konkurs paraqiten 200 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë, zgjedhja do të bë



# NIS EDICIONI I DYTË I FESTIVALIT TË DRAMËS SHQIPE "METROFEST"

Festivali i përvitshëm "Metrofest" do t'i kushtohet këtë vit tërësisht dramës shqipe. Ndërkohë që në teatër po punohet me provat për shfaqjet përkatëse, nga përzgjedhja e veprave bie në sy sidomos "Loja e pasdrekës" nga Martin Camaj



Vepra shqiptare të harruara në sirtarët e bibliotekave apo arkivit, vepra që janë pjesë të fondit të teatrove, shpluhurosen e vijnë këtë tetor në "Metrofest", festivalin e dramës shqiptare të arkivit.

Veprat edhe në këtë edicion të II janë përzgjedhur nga regjisorja Sonila Kapedani.

Ndryshe nga viti i shkuar ky edicion sjell më pak vepra, sepse realizimi i tyre ka kosto për teatrin e metropolit që këtë here është i vetëm në këtë sfidë. Ky festival nuk ka natyrë konkurruese, por e vë theksin tek laboratorit i punës me veprën shqiptare, me anë të së cilës vështirë të joshës publiku.

Ndaj ky festival i ardhur si pretekst për njohje dhe krijim, i fton spektatorët e kryeqytetit të zbulojnë së bashku shtigje dhe përgjigje.

Festivali i përvitshëm "Metrofest" do t'i kushtohet këtë vit tërësisht dramës shqipe.

"Viti i parë është zgjedhur me temë dramën shqipe, për t'u dhënë mundësinë dramave që janë të panjohura për spektatorin, por edhe për krijuesin, drama që janë nxjerrë nga arkivat", tha Sonila Kapidani, drejtoreshë e festivalit.

Ndërkohë që në teatër po punohet me provat për shfaqjet përkatëse, nga përzgjedhja e veprave bie në sy sidomos "Loja e pasdrekës" nga Martin Camaj.

"Veprat e reja që janë duke u punuar aktualisht dhe që do të vijnë në skenë ditët e festivalit janë 'I biri i Begut' nga Milo Duçi, 'Armiqtë' nga Shpëtim Gina e bërë rreth vitit 1972, si dhe 'Loja e pasdrekës' e autorit Martin Camaj", tha më tej Sonila Kapidani.

Nga data 3-7 tetor dhe 10-14 tetor, teatri do t'i kushtohet tërësisht dramës shqipe, e pas shfaqjeve do të ketë edhe një panel diskutimi për këtë, i cili edhe më herët nuk ka munguar si nismë, por pjesëmarrësit nuk kanë qenë të

shumtë.

Një pjesë e regjisorëve të përzgjedhur nga "Metrofest" janë ende duke kryer masterin pranë Universitetit të Arteve.

"Regjisorët janë Xhuliano Brikku, duke vënë 'Armiqtë' nga Shpëtim Gina; Joana Omeraj duke vënë në skenë 'I biri i Begut' i Milo Duçi; si dhe Shkëlzen Berisha me 'Lojën e pasdrekës' të Martin Camajt", u shpreh drejtoresha e festivalit.

Por edhe pse festivali teatror "Metrofest" pritet të nisë në ditët e fundit e muajit tetor, pranë teatrit bëhet me dije ky sezon deri në dhjetor do të nxjerrë në dritë vepra shqiptare të shpluhurosura nga arkivi, por edhe vepra të njohura në mbarë botën. Projekti do të përfshijë aktorë karriere apo aktorë të rinj, regjisorë me eksperiencë apo regjisorë me potencial të ri artistik.

Drejtoresha e Teatrit Metropol, Jonida Beqo, është shprehur se të pesta premierat teatrore, që priten të vijnë në skenë janë produksione ekskluzive të institucionit. "Ashtu si në edicionin e parë, edhe sivjet Teatri Metropol, i dedikohet njohjes dhe vënies në skenë të dramaturgjisë shqiptare.

Qëllimisht ky festival nuk ka natyrë konkurruese, por e vë theksin tek laboratorit i punës me veprën shqiptare. Të pesë premierat e këtij edicioni janë produksione ekskluzive të Metropolit, duke afruar profesionistë të teatrit nga të gjitha brezat për të hulumtuar dhe për t'i dhënë frymë dramës shqipe në skenë, afër publikut", bën me dije Beqo.



## Volteri për Skënderbeun

Që për Skënderbeun ka shkruar veç shumë të tjerëve edhe Volteri? Frensis Marie Arouet (1694-1778)-Volter, konsiderohet si filozofi kryesor i "renesansës" evropiane, së bashku me Rusoin. Veç traktateve filozofiko politike dhe letërsisë, ai ka shkruar edhe libra dokumentarë me karakter studimor e historik, mes të cilëve dhe "Sprovë mbi zakonet e kombeve", nga e cila është shkëputur pjesa e mëposhtme:

"...E kam fjalën për Skënderbeun, lindur në Shqipëri. Ai ishte bir i një despoti apo zotërie të asaj krahine, domethënë i një princi vasal... Skënderbeu kur ishte njëzet vjeç mendoi të arrinte qëllimin e vet."

Të mos kishte më zotërinj mbi kokë dhe të mbretëronte i lirë. Skënderbeu e kishte rimarrë kurorën e atit të vet që e meritonte për shkak të kurajës së tij."

Duke ngritur kurajon e shqiptarëve theksoj: "Shqiptarët janë ushtarët më të mirë të atyre anëve. Skënderbeu diti mirë të shfrytëzojë trimërinë e tyre dhe terrenin e ashpër malor të vendit të vet, prandaj me pak trupa ai ndali gjithmonë armata të shumta osmane, e shqiptarët janë epiriotët e lashtë, të cilët janë aq luftëtarë sa edhe stërgjyshërit e tyre...!"

Ata janë një racë luftarake dhe Shqipëria është një vend malor. Këta dy fakte ndihmuan Skënderbeun në fushatat e tij..."

(Nga libri "Sprovë mbi zakonet e kombeve" në anglisht)

# FESTIVALI I FILMIT "BALKAN FILM MARKET" Mbledh profesionistë nga e gjithë bota

Rikthehet "Balkan Film Market" në edicionin e tij të dytë nga data 3-7 tetor 2018 në Tiranë nga Iceberg Communication dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK). Për pesë ditë me radhë "Balkan Film Market" do të shërbejë si një platformë për të sjellë më pranë profesionistë të botës së filmit nga Europa dhe Ballkani për të ndarë historitë, për të nxitur marrëdhëniet profesionale dhe për të zhvilluar edhe më tej përpjekjet marketing për prodhimet vendore kinematografike.

"Balkan Film Market" do të mbledhë për të dytin vit producen-



te dhe kineastë nga gjithë Ballkani të cilët po mësojnë si të vendo-

sin kontaktet e duhura dhe të orientohen për gjetjen e bashkë-

producentëve që është edhe çelësi kryesor për të patur akses në fon-

det evropiane të filmit.

Në BFM do të jenë të pranishme një shumëllojshmëri alternativash edukative, pa harruar diskutimin e paneleve mbi problematikën e industrisë së filmit në Ballkan dhe mundësitë për të rritur përpjekjet për bashkëprodhim dhe për t'i konkretizuar ato në projekte konkrete.

Organizatorët shprehen se "Edhe këtë vit producentët më të suksesshëm të kinemasë evropiane të viteve të fundit do të jenë prezentë në ngjarjen më unike në skenën ballkanike të filmit që organizohet në Tiranë."



“Tani unë jam bërë vdekja, shkatërruesja e botëve”. Këto janë fjalët që mendoi Robert Openhajmer, pasi u bë dëshmitar i shpërthimit të parë të një bombe atomike më 16 korrik 1945. Në atë moment, ai e kuptoi fuqinë e vërtetë dhe potencialin e tmerrshëm të zgjuarsisë teknologjike. Tre të katërtat e amerikanëve por jo vetëm, janë të frikësuar se çfarë do të thotë teknologjia për njerëzimin. Ja cilat janë 10 arsye, se përse frika e tyre mund të jetë e justifikuar

**10. MAKINAT DO TË ZËVENDËSOJNË NJERËZIT.** Në fillim të viteve 1800, punëtorët anglezë të njohur si Luditë, i shkatërruan makineritë që përpunonin pambukun dhe leshin, pasi ato ishin bërë shkak i largimit të tyre nga puna. Që nga revolucioni industrial, automatizimi ka vazhduar në mënyrë të pandërprerë, duke zëvendësuar njerëzit. Mbrojtësit e procesit, thonë se po krijohen vende të reja pune për të zëvendësuar të vjetrat. Dr. Karl Benedikt Frej, bashkëdrejtues i programit Oxford Martin mbi teknologjinë dhe punësimin në universitetin e Oksfordit, pranon se automatizimi zhduk vendet e punës që kanë ka pak aftësi. Por ai gjithashtu argumenton, se teknologjia ka rritur gamën e detyrave që mund të kryejnë punëtorët e kualifikuar.

**9. ROBOTËT.** Nëse teknologjia zëvendëson njerëzit, ka shumë të ngjarë që kjo të jetë në formën e robotëve. Fjala “robot” vjen nga fjala çeke “robota”, që do të thotë “sklavëri”. Ky term u krijua për dramën e shkrimtarit Karel Capek në vitin 1920 “Robotët Universalë Rosum”. Në atë dramë, një forcë punëtore e sofistikuar robotësh, rebelohet për të shkatërruar njerëzimin. Analistët parashikojnë se tregu global i robotëve, do të vlejë mbi 100 miliardë dollarë deri në vitin 2025. Kjo do të thotë që makineritë autonome - në shtëpitë, dyqanet, në rrugët tona dhe në qiell - mund të jenë kudo.

Megjithatë, avokati Nik Roxhers thekson se teknologjia robotike, është zhvilluar përpara caktimit të çdo lloj rregulloreje. Aftësitë potenciale të robotëve, janë aktualisht të pafundme. Analisti i kërkimit të teknologjisë, Xhek Karsten dhe politologu Darell Uest, paralajmërojnë se “do të jetë gjithnjë e më e rëndësishme që politikëbërësit të marrin një rol aktiv në sigurimin që robotët ... të evoluojnë në një mënyrë që është

# 10 ARSYE PSE DUHET TA KEMI FRIKË TEKNOLOGJINË

vetëm e dobishme për njerëzimin”.

**8. TERRORIZMI KIBERNETIK.** Fjalori i Oksfordit, e përcakton terrorizmin kibernetik si “përdorimin e paligjshëm dhe shpesh të motivuar politikisht të kompjuterave ose teknologjisë së informacionit për të shkakuar përçarje, frikë ose humbje financiare”. Ros Rustiçi, drejtor në kompaninë e sigurisë kibernetike “Cybereason”, thotë se lufta kibernetike është një kërcënim real, pasi interneti dhe mbështetja në sistemet e lidhura me të, është bërë “thjesht realiteti i ri”. Tashmë, hakerat rusë janë akuzuar për sulme ndaj shërbimeve publike në Ukrainë në vitin 2015 dhe SHBA më 2017-ën. Sulme të tilla, të koordinuara në infrastrukturën e një kombi, mund të shkaktojnë ndërprerje të energjisë elektrike, ose përmbytje duke ndryshuar funksionin e pompave të ujërave të zeza. Ekspertët parashikojnë se terrorizmi kibernetik, do të bëhet një mënyrë e re standarde e të zhvilluarit një luftë.

**7. MBIKËQYRJA.** Njerëzit kapen në kamerat CCTV deri në 100 herë në ditë. Është një masë sigurie që e tolerojnë të gjithë - ose të paktën duket se e tolerojnë, pasi është e vështirë të thuhet, që qytetarët e zakonshëm janë të vetëdijshëm për vendndodhjen e miliona kamerave CCTV. Për më tepër, softueri i njohjes së fytyrës, është tani kaq shumë i sofistikuar, sa që mund

të krahasojë fotot e kartës së identitetit me imazhet e kapura në kamerat CCTV. Për më tepër, disa satelitë në hapësirë mund të ofrojnë imazhe të definicionit të lartë të shtëpisë, kopshtit tuaj ... dhe fatmirësisht jo të brendisë së dhomës apo makinës tuaj. Në vend të kësaj, mikrofonat dhe kamerat të vendosura në një kompjuter, tableta dhe telefona celularë, mund të përdoren për të monitoruar aktivitetet intime të përditshme.

**6. ARMËT E SHKATËRRIMIT NË MASË (WSD).** Njerëzimi ka jetuar nën hijen e WMD-ve, që kur ky term u krijua në vitin 1937. Asokohe, fraza përshkruante sulmet masive të avionëve bombardues. Dhe u përdor shumë shpejt, për të përshkruar fuqinë e jashtëzakonshme të bombës atomike, e cila në atë kohë dukej e patejkalueshme në potencialin e vet shkatërrues. Që nga ajo kohë, është ndërtuar një bombë me pothuajse 4 mijë herë fuqinë e bombave të para atomike. Tani ka mijëra armë bërthamore në mbarë botën, të mjaftueshme për të shkatërruar të gjitha qytetet kryesore të planetit. Një dimër bërthamor do të zhyste Tokën në errësirë, dhe do të shkaktoje një uri masive, teksa të mbjellat do të shkatëroheshin. Shkencëtarët parashikojnë se edhe një luftë bërthamore në shkallë të vogël, do të vriste të paktën 1 miliardë

njerëz. Në shkallë të plotë, një luftë bërthamore do të zhdukte gjithë racën njerëzore.

**5. FUNDI I DIJES.** Smartfonët, programet automatike të korrigjimit, navigimi me GPS...A janë njerëzit duke u mbështetur tek teknologjia? Studimet tregojnë se kujtesa afatgjatë e gjeneratave të reja, po bëhet më e vogël, falë varësisë së tyre nga motorët e internetit, telefonat elektronikë dhe lajmërimet kalendarike etj. Një ditë, të gjitha të dhënat mund të bëhen digjitale. Asnjë regjistër i shkruar, asnjë libër, vetëm informacioni ruajtur në kodin binar. Ky lloj magazinimi elektronik, është i rrezikuar të hakerohet apo fshihet aksidentalisht. Nëse ndodh një katastrofë - qoftë përmes terrorizmit kibernetik, parashikohet që ne do të hyjmë në një Epokë të re të Errët të kaosit, injorancës dhe nëse shoqëria do të përkeqësohet, ndoshta edhe një epokë të dëshpëruar të mbijetesës.

**4. INXHINIERIA GJENETIKE.** Në vitin 2016, Autoriteti i Fertilizimit të Njeriut dhe Embriologjisë në Mbretërinë e Bashkuar (HFEA), aprovoi përdorimin eksperimental të procesit të redaktimit të ADN-së, për të aktivizuar dhe çaktivizuar gjenet në një vezë të sapofekunduar. Me anë të saj, ne mund të korrigjohim defektet gjenetike, apo çaktivizojmë gjenet që shkaktojnë sëmundje si anemia, HIV

apo tumore të caktuara. Megjithatë, askush nuk e ka zgjidhur dilemën etike të nëse duhet apo jo ta bëjmë këtë. Në Kinë po mbahen sot gjyqe për këtë çështje, ndërsa edhe në vendet e tjera ka shumë polemika. Kjo është për shkak se manipulimi i gjenomit njerëzor, mund të ketë implikime të tmerrshme për çdo person apo qeveri, që dëshiron të krijojë super-ushtarë apo të angazhohet në një program eugenik.

**3. EFEKTET E PADËSHIRURRA ANËSORE.** Në vitin 1979, Robert Uilliams, një ndërtues i makinave Ford në Miçigan, u regjistrua si personi i parë, që u vra nga një robot industrial. Këtë vit, Elen Herzberg u bë personi i parë i regjistruar që u vra nga një veturë që vete-drejtohet, “Vivek”. Shpesh paralajmërohet se “çdo teknologji, e ka një anë të errët”. Nëse do të arrihet që nanobotët të vetë-riprodhohen, ato do të shtohen aq shumë, duke gllabëruar lëndët e para, dhe përfundimisht do të gllabërojnë gjithë botën brenda një dite apo më shumë.

**2. INTELIGJENCA ARTIFICIALE.** Fizikanti Stefën Houking, paralajmëroi se inteligjenca artificiale “mund të parathotë fundin e racës njerëzore”. Dhe ai nuk ishte i vetmi që e mendon këtë. Bill Gejts, Tim Berners-Li, Stiv Vozniak dhe Elon Mask, i frikësohen gjithashtu inteligjencës artificiale. Edhe pse zhvillimi i plotë i Inteligjencës Artificiale, ka qenë shumë më i ngadaltë sesa pritej, ekspertët tanimë bien dakord se ajo do të arrijë atë njerëzore në vitin 2047.

**1. ABUZUESIT E TË DHËNAVE.** Në epokën digjitale, shkeljet me të dhënat private ndodhin çdo ditë, tek individët ose komunitetet. Korporatat e mëdha mbajnë informacione për kaq shumë njerëz, sa që hakerat mund dhe kanë kryer shkeljet realisht të mëdha me të dhënat. Në vitin 2013, ata vodhën të dhënat e 3 miliardë klientëve të Yahoo. Në mbarë botën, qeveritë vlerësojnë se individët privatë humbasin miliardë dollarë çdo vit, si pasojë e abuzimit me të dhënat e tyre private. (AllTimeCons)





DRITA NUK E LËSHON ARDIAN NUHIUN

# ARTIM SHAQIRI TRAJNER I SHKUPIT?

Pas largimin të trajnerit turk Hajat Sojdash nga FC Shkupit, këta të fundit janë hedhur në sulm për të gjetur trajner të ri. Çairasit ishin në bisedime me Ardian Nuhiun mirëpo ky i fundit nuk largohet nga Drita. Sipas burimeve të gazetës Koha drejtimin e Shkupit pritet ta merr trajneri strugan Artim Shaqiri

Koha

Fisnik NUHIU



Shkup, 3 tetor - Skuadra e FC Shkupit pas largimin nga detyra e trajnerit Hajat Sojdash është hedhur në sulm për të gjetur zëvendësin e tij. Së fundmi ata ishin në bisedime me trajnerin shkupjan Ardian Nuhiu i cili me shumë gjasa nuk do të kthehet në Çairt. Shkupi ishte në bisedime me rikthimin e Nuhiut në pankinë, mirëpo nga Drita e Gjilani nuk e ka pranuar largimin e tij. Nuhiu te Drita punon sëbashku me trajnerin nga Shqipëria, Shpëtim Duron i cili më herët ishte trajner i Shkëndijës nga Tetova. Sipas burimeve të gazetës Koha drejtimin e Shkupit pritet ta merr trajneri strugan Artim Shaqiri i cili për momentin është pa detyrë. Shaqiri më herët kishte udhëhe-

qur ekipet si Shkëndija e Tetovës dhe Kukësin e Shqipërisë. Artim Shaqiri është i njohur si një nga lojtarët e dalluar të shumë kampionateve evropiane, ndërsa ai njihet sidomos pranë kampionatit të Premierligës angleze derisa ishte sulmuesi i West Bromwich Albion. Shaqiri në gusht të vitit 2009 i dha lamtumirë reprezentacionit, duke u përkushtuar më pas në synimet e tij për të qenë trajner i suksesshëm dhe që u pajis më pas me licencën ndërkombëtare. Për momentin skuadrën është duke e udhëheqë trajneri ndihmës Faruk Jonuz, ndërsa pritet që gjatë ditëve të bëhet i ditur edhe emrin e trajnerit të ri. Ndryshe nga skuadra e

Shkupit pas trajnerit Hajat Sojdash është larguar edhe pronari i klubit Shefshet Demiri ka vendosur të largohet nga kryesia e skuadrës, por duke mbetur edhe më tutje si mbështetës i FC Shkupit. "Sigurisht se kemi pritur të kemi suksese që në fillim të sezonit, por punët nuk shkuan ashtu siç i kishim planifikuar.

Por duke marrë parasysh faktin se unë kohën më të gjatë e kaloj jashtë Maqedonisë dhe nuk mundem të jem afër klubit, kam vendosur që të largohem nga kryesia e klubit dhe të mbetem deri në fund mbështetës i kësaj skuadre. Shpresoj se punët do të shkojnë nga e mira dhe shumë shpejt Shkupi do

të kthehet me rezultat e dëshiruar, pasi që unë që në fillim kam besuar në këtë projekt dhe besoj që punët do të shkojnë edhe më tej nga e mira. Unë publikisht ftoj të gjithë dashamirët e klubit, e në veçanti "Shvercerat" që të jenë mbështetja më e madhe e skuadrës, pasi që ata gjithmonë ishin dhe do të jenë arma më e fortë e klubit, andaj ju ftoj që në numër sa më të madh ta mbështetni klubin që të dalim së bashku nga kjo krizë", ka thënë Shefshet Demiri. Përndryshe largimi i Demirit nga kryesia e klubit nuk do të ndikojë tek sponsorët e klubit, të cilët vazhdojnë edhe më tutje të mbesin mbështetës të këtij projekti.



## La Kosovën për Shqipërinë, vjen reagimi i federatës për Dermakun

Mbrëmjen e së martës trajneri i ekipit kombëtar, Christian Panucci, publikoi listën e lojtarëve të grumbulluar për dy ndeshjet rradhës, atë ndaj Jordanisë dhe Izraelit, që do të luhen javën e ardhshme. Mes futbollistëve të grumbulluar binte në sy edhe emri i mbrojtësit Kastriot Dermaku, që në fakt ishte befasi për shumë kënd. Më herët ai ishte grumbulluar nga Skënder Gega, kur ky i fundit trajnonte Shpresat e Shqipërisë, por më pas ishte lënë në harresë. Ndërkohë që pak kohë më parë, Kastriot Dermaku, u grumbullua nga Kosova, teksa nuk u aktivizua në asnjërin nga ndeshjet me Azerbajxhanin dhe Ishujt Faroe. Ndërkohë pas vendimit të mbrojtësit për t'u grumbulluar me Shqipërinë, ka ardhur dhe reagimi i parë nga Kosova. Menaxheri i përfaqësueses së Kosovës, Bajram Shala, ka folur për gazetën kosovare "Insporti", duke theksuar se vendimi Dermakut është personal. "Është zgjedhje personale e lojtarit të cilën në e respektojmë. Ndoshta lojtari nuk ka arritur që të adaptohet. Ndoshta nuk është ndjerë mirë. Ndoshta e ka parë konkurrencën, nuk e di se çfarë të them më tepër", ka deklaruar Bajram Shala. Ai ka mohuar kategorikisht mundësinë që Dermaku ka pasur ndonjë problem te Kosova. "Absolutisht nuk ka pasur asnjë problem gjatë kohës sa ka qenë i tubuar me Kosovën", theksoi Bajram Shala.

## Shabani shënon për Bayernin në Ligën e Kampionëve

Talenti kosovar, Meritan Shabani, ka shënuar gol në Ligën e Kampionëve për skuadrën Bayern Munich ndaj Ajaxit (ekipi i rinjve). Meritan Shabani vazhdon të shkëlqej te të rinjtë e Bayern Munich. Mesfushori 19 vjeçar ka arritur të shënoji në Ligën e Kampionëve, në

ndeshjen e të rinjve mes Bayern Munich U19 dhe Ajax 19, e cila përfundoi barazim 2:2. Shabani shënoi në minutën e 72' të ndeshjes për të kaluar Bayernin në epërsi prej 2:1, por mysafirët nga Holanda ia dolën që në fund të ndeshjes të barazojnë në 2:2.



## FFM nderon yjet e ndeshjes së parë të Maqedonisë


Shkup, 3 tetor - Reprezentacioni i Maqedonisë në futboll me fitore i ka hapur dy ndeshjet e para në kuadër të Ligës së Kombëve. Garë prej të cilës Maqedonia për herë të parë në histori do të mundohet që të plasohet në Kampionat Evropian. Kështu për Maqedoninë ndeshjet kualifikuese vazhdojnë me 13 tetor, ku së pari në Arenën "Filipi i Dytë", do të pret Lihtenshtajnin ndërsa tre ditë më vonë do të jetë mysafiri e Armenisë. Fede-

rata Futbollistike e Maqedonisë ka vendosur që para sfidës ndaj Lihtenshtajnit, në kuadër të raundit të tretë të Ligës së Kombëve, të organizojë një manifestim të vogël, me rastin e 25 vjetorit nga ndeshja e parë e përfaqësueses së Maqedonisë në futboll. Futbollistët që ishin në sfidën e parë, historike dhe shënuan fitore 4-1 ndaj Sllovenisë, do të defilohen para përballjes me Lihtenshtajnit, më 13 tetor. Trajneri Andon Donçevski dhe

Darko Pançevi do të drejtojnë yjet, të cilët do të nderohen me shpërblime nga FFM. Ndryshe prej sot Federata e Futbollit të Maqedonisë kanë vënë në shitje biletat për sfidën me Lihtenshtajnin, të cilat kushtojnë 100 denarë për tribunën e Jugut dhe 150 denarë për atë të Veriut. Përfaqësuesja e Maqedonisë, në dy sfidat e para të Ligës së Kombëve shënoi fitore me rezultat identik 2-0, ndaj Gjibraltarit dhe Armenisë.







**Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale**  
rr. Makedonija nr. 38, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë  
Tel. + 389 2 3103 400,  
[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)

contact@avmu.mk

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale shpall:

#### SHPALLJE PUBLIKE

- Për punësim në shërbimin profesional të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, për këto vende të punës:
  - Bashkëpunëtor për rregullativë dhe çështje analitike-juridike në Seksionin për çështje normative-juridike pranë Sektorit për çështje juridike, 1 (një) realizues, në kohë të caktuar prej 9 (nëntë) muajve
  - Bashkëpunëtor për çështje juridike dhe resurse njerëzore në Seksionin për çështje administrative juridike pranë Sektorit për çështje juridike, 1 (një) realizues, në kohë të caktuar prej 9 (nëntë) muajve
- Krahas kushteve të përgjithshme, të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët për punësim në këto vende të punës nga pika 1 e këtij vendimi, duhet të plotësojnë kushtet në vijim:
  - PLP, së paku 180 kredi të fituara sipas SETK ose shkallën VII/1 të arsimimit, nga sfera e drejtësisë;
  - së paku 1 (një) vit përvojë pune në këtë lëmi;
  - njohje aktive të gjuhës angleze ose franceze ose asaj gjermane;
  - aftësi pune me kompjuter;
  - aftësi për punë në presion dhe kryerje të detyrave të punës me afat;
  - ndershmëri dhe lojalitet;
  - komunikim efektiv verbal dhe të shkruar;
  - aftësi për punë ekipore
- Orari ditor i punës: Nga ora 07:30/08:30 e deri në ora 15:30/16:30.
- Orari javor i punës: 40 orë.
- Ndarja e orarit të punës: Nga e hëna e deri të premten.
- Paga bazë neto për vendet e punës të caktuar në pikën 1 të këtij konkursi publik, për të cilin kërkohen punëtor është 30.170,00 denarë
- Kandidatët, përveç lutjes, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:
  - letër motivuese;
  - biografi të shkurtë (CV);
  - diplomë për arsimin e lartë ose vërtetim për provime të kryera.
  - vërtetim të shtetësisë;
  - vërtetim/dëshmi për përvojë pune për vendin e punës;
  - vërtetim/dëshmi për aftësi pune me kompjuter;
  - vërtetim/dëshmi për njohje aktive të gjuhës angleze ose franceze ose asaj gjermane.
- Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët duhet ta dorëzojnë në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter. Secili pjesëmarrës në këtë shpallje publike ka të drejtë Që të dorëzojë edhe dokumente tjera për prezantim personal.

9. Afati i paraqitjes së kandidatëve është 3 (tri) ditë punë llogaritur nga dita e shpalljes. Përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet në afat prej 45 (dyzetepesë) ditëve, pas skadimit të afatit për paraqitjen e kandidatëve. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që nuk janë parashtruar në kohë, si dhe dokumentet që nuk janë dorëzuar në origjinal ose si kopje e vërtetuar në noter nuk do të shqyrtohen. Dokumentet të dorëzohen në adresën Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Pallati Panko Brashnarov, rr. "Maqedonia" nr. 38, 1000 Shkup ose në arkivin e Agjencisë nga ora 08:00 deri në orën 16:00. Informata shtesë, në lidhje me këtë konkurs mund të merren nga këto persona: d-r Andriana Skerlev Çakar tel:02/3103-411 dhe m-r Ivona Mufisheva Aleksovska tel:02/3103-413

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale

Në bazë të nenit 160, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe 120/2018), dhe Lajmërimit nr. 18-7870/2 të datës 19.7.2018, nga Ministria e financave, për marrjen e pëlqimit për punësim të personave në Institutin për blegtori në Shkup pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup nga Ministria e financave, Instituti për blegtori në Shkup pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

#### SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2018 Për punësim

Instituti për blegtori në Shkup ka nevojë për punësim të personave për kohë të pacaktuar në Institutin për blegtori pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, edhe atë:

- Një (1) person në vendin e punës: *këshilltar për resurse njerëzore*,  
**Kushtet:**
  - Arsim sipëror ose së paku 240 kredi sipas SETK nga fusha shkencore: Linguistikë (gjuha italiane)
  - Përvojë pune prej së minimum 2 vjet në profesion;
  - Orari javor i punës është 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte;
  - Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 08:00 - 16:00;
  - Neto pagesa fillestare 21.903,00 denarë.
- Një (1) person në vendin e punës: *bashkëpunëtor i ri për kontabilitet financiar dhe punë materiale*,  
**Kushtet:**
  - Arsim sipëror ose së paku 180 SETK nga fusha shkencore: shkencat ekonomike;
  - Përvojë pune prej së minimum 3 vjet në profesion;
  - Orari javor i punës është 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte;
  - Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 08:00 - 16:00;
  - Neto pagesa fillestare 21.903,00 denarë.

Kandidatët duhet ti përmbushin kushtet e përgjithshme (të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, në mënyrë aktive të njohin gjuhën maqedonase, të jenë të moshës së rritur, të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës).

Dokumentacioni i nevojshëm: fletëparaqitje me shënim të vendit të punës për të cilin konkurrohet, biografi, certifikatë dhe diplomë, certifikatë për kontabilitet të autorizuar, diplomë ose dokument tjetër për njohje aktive të gjuhës angleze dhe italiane dhe njohje të punës me kompjuter, dëshmi për përvojën e punës.

Në fletëparaqitje kandidatit obligohet të shënojë, adresë, numër të telefonit dhe e-mail adresë.

Afati për paraqitje është pesë ditë pune nga dita e publikimit. Nevoja për publikim të shpalljes publike, të publikohet në shtypin ditor, në gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gazetë ditore në gjuhën shqipe.

Me kandidatët e paraqitur duhet të realizohet intervistë. Zgjedhja e kandidatit do të realizohet në afat prej 45 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje. Fletëparaqitja së bashku me dokumentet të parashtruar në arkivin e Institutit për blegtori në Shkup ose përmes postës në adresën: Instituti për blegtori në Shkup, rr. bul. Ilinden, nr. 95a, F. P 207, 1000 Shkup.

Instituti për blegtori – Shkup  
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup

Nr. 10-177/21dt. 01.10.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18, 168/18) dhe Vendim me nr. 10-177/20 dt. 01.10.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

#### KOMUNIKATË

##### për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike - Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63 KK Tetovë 1, me nr. tek. 2-4/17 i përpunuar nga "URBANPLAN" – SHPK Tetovë. Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përshirjes planore definohet përmes rr. "Bllagoja Toska", rr. "Mehmet Pash Deralla (29 Nëntori)", rr. "Dervish Cara" dhe rr. "Dimo Gavrovski Kara".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 2.23 ha.

Brenda përshirjes planore të Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në shtëpi banesore, A2 - banim në shtëpi kolektive, E1 - Infrastruktura komunale.

**ANKETA PUBLIKEE PËRSËRITUR** - Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, komuna e Tetovës, do të zgjatë 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 15.10.2018 – 19.10.2018 vjet. Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës [www.tetovo.gov.mk](http://www.tetovo.gov.mk) dhe në sistemin e e-urbanizmit.

**PREZANTIMI PUBLIK I PËRSËRITUR** - Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 16.10.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese në përmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës [www.tetovo.gov.mk](http://www.tetovo.gov.mk), informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,  
Teuta Arifi



SHKOLLA SHTETËRORE PËR EDUKATË FIZIKE "METODI MITEVSKI – BRICO" –

GJIMNAZI PËR SPORT

STATE SCHOOL OF SPORT CULTURE "METODI MITEVSKI-BRICO"-Skopje  
SPORT GYMNASIUM

Në bazë të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të shkollave të mesme nr. 19-2251 të datës 05.03.2013 të Ministrisë së arsimit dhe shkencës, SHSHEF "Metodi Mitevski – Brico" – Shkup, publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursionit përfundimtar për nxënësit jashtë Republikës së Maqedonisë, në Itali (Venecia dhe Veronë).

Në shpallje mund të paraqiten subjektet juridike të cilët plotësojnë kushtet në vijim:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me Dispozitat pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë, për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike
- Të ketë të realizuara në mënyrë të suksesshme së paku tre ekskursione shkollore në tre vitet e fundit
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Subjektet e interesuara juridike mund të marrin dokumentacionin e nevojshëm në shkollë në adresën në vijim: rr. "Dimçe Mirçev" nr. 1 – Shkup.

SHSHEF "Metodi Mitevski – Brico"  
Komisioni për grumbullim të ofertave

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor dhe Pëlqimit të Ministrisë së financave nr. 18-10396/2 të datës 11.09.2018 Shkolla fillore komunale "Johan Hajnrih Pestaloci"- Shkup, publikon

#### SHPALLJE

##### Për nevojën e kuadrit mësimor për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019, deri më 31.08.2019

1. Mësimdhënës të mësimi klasor për 20 orë mësimore...dy realizues, me neto pagesë prej 20.640,00 den. Orari i punës i mësimdhënësve është me dy ndërrime dhe përfundon sipas numrit të orëve në pajtim me Orarin e orëve për vitin 2018/2019.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme të caktuara me Ligin për arsim fillor.

3. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- biografi të shkurtë
- dokument për arsim të mbaruar përkatës
- certifikatë të shtetësisë

4. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

5. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 5 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

6. Dokumentet e dorëzuara si të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

7. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në adresën: "Apostoll Gusllarot" nr. 3, SHFK "Johan Hajnrih Pestaloci"- Shkup.

SHFK "Johan Hajnrih Pestaloci"- Shkup





# NDOMBELE, 'KANTE I RI'

**Mesfushori i Lyonit, Tanguy Ndombele, është duke shkëlqyer në ligën franceze. Ai nuk e ka marrë vëmendjen e njëjtë gjatë verës sikur Memphis Depay, Mariano Diaz dhe Nabil Fekir, por Ndombele ka qenë ai që ka mundur bashkëlojtarëve të tij. Tashmë kanë filluar krahasimet mes tij dhe mesfushorit të Chelsea, N'Golo Kante**

Roli i mesfushorit defensivë mund të jetë mjaft i vështirë. Që të jesh i suksesshëm në këtë pozicion duhet të kesh një balancë mes energjisë, strategjisë, teknikës dhe disiplinës. Të gjitha këto aftësi kalojnë në një vëmendje të veçantë. N'Golo Kante përfaqëson një shembull të përkryer. Marseille kishte refuzuar mundësinë që të nënshkruante me ish-futbollistin e Caenit në vetën e vitit 2015, duke konsideruar se ai ishte shumë i shtrenjtë, sidoqoftë së pari në Leicester City dhe tani në Chelsea ai është kthyer në njërin prej lojtarëve më të mirë të kësaj loje dhe njëri prej futbollistëve kyç të Francës, që triumfoi në Kupën e Botës. "Të kaltrit" janë të vetëdijshëm për vlerën e njërit prej futbollistit më të ndrojtur dhe më të nënvlerësuar. Paris Saint-Germaini provoi jashtëzakonisht shumë që ta transferonte mesfushorin e palodhur 27-vjeçar. Sidoqoftë ekipi nga "Stamford Bridge" nuk e lejoi largimin e tij dhe parisienët përpiluan një listë të zëvendësuesit të tij. Mjaft lart në atë listë ishte mesfushori i Lyonit, Tanguy Ndombele, një lojtar

i panjohur jashtë Francës, por i vlerësuar mjaft shumë dhe i krahasuar me Kanten. Pas një paraqitjeje të mrekullueshme ndaj Manchester Cityt, derisa klubi francez e befasoi atë anglez në "Etihad" në Ligën e Kampionëve, për të pritjet vetëm sa u shtuan. 21-vjeçari është pjesë e Lyonit prej më shumë se një viti, ndërsa së pari me Amiensin, që e ndihmoi të promovohet në kategorinë e parë franceze. Ai e kaloi edicionin e kaluar si i huazuar te Lyonit, ndërsa gjatë verës ky transferim u bë i përhershëm, me një vlerë prej 8 milionë eurosh. Pak kohë më pas është raportuar se Lyoni ka refuzuar oferta prej 50 milionë eurosh nga Manchester City. Memphis Depay, Mariano Diaz dhe Nabil Fekir mund të kenë tërhequr vëmendjen gjatë verës, por disa të tjerë e kanë vlerësuar mesfushorin e talentuar, që i ka ndihmuar ata yje që të shkëlqejnë. Philippe Lemaire, një ish-skaut i Guingampit, të cilit i kishte shpëtuar lojtari nga dora, ka folur shkurtimisht për lojtarin. "Ai është gjithçka në futboll. Ai është i fort dhe preciz. Ai e ndien lojën. Ai është

i aftë që të krijojë diçka, t'i japë ritëm lojës, të kundërsulmojë, por gjithashtu të bëjë presion dhe të marrë përsëri posedimin e topit", ka deklaruar Lemaire. Leximi i tij i lojës ka bërë që ai më herët të luajë si mbrojtës i djathtë ose si sulmues i djathtë në Amiens, ndërsa "pozicioni i zemrës së tij" sipas ish-bashkëlojtarit të tij Yoane Wissa ishte si numër dhjetë. Sidoqoftë, lojtari është rehatuar në Lyon me rolin e mesfushorit të qendrës që ndihmon sulmin dhe mbrojtjen, kështu që krahasimi mes Ndombeles dhe Kantes nuk është edhe aq i drejtë. Ai jo vetëm që është shumë më i gjatë dhe më atletik, por ai gjithashtu është në gjendje të mbajë topin dhe të bëjë një pasim sulmues, derisa gjithashtu është duke mbuluar përgjegjësitë e tjera. Në të vërtetë është një ish-lojtar i Chelsea që presidenti i Lyonit, Jean-Michel Aulas, e krahason Ndombelen. "Ai më kujton Michael Essienin", thotë Aulas. Momentalisht Ndombele ka shënuar vetëm një gol nga 56 ndeshje. "Mendoj pak më shumë sesa duhet paragoditje", ka thënë Ndombele, i

cili e ka kompensuar këtë me katër asistime në tetë ndeshje kampionate këtë edicion. "Jam duke punuar për këtë gjë dhe që ta përmirësoj veten", ka shtuar ai. Sidoqoftë, kjo çështje nuk mund ta pengojë Didier Deschampsin që ta ftojë atë për herë të parë në kombëtaren e Francës të enjten për ndeshjet e ardhshme kundër Islandës dhe Gjermanisë. Ai ka aftësi të ngjashme me Corentin Tolissos, i cili ka një lëndim serioz në gju e që ia ka hapur rrugën ish-bashkëlojtarit të tij që të debutojë në arenën ndërkombëtare. Aty ai do të ketë kontakt me Kanten si bashkëlojtar dhe përderisa profilet e tyre mund të mos jenë edhe aq të ngjashme në fushën, ata pa dyshim që ndajnë diçka të përbashkët. "Më pëlqen të flas në fushë. Nuk ndihem rehat me mikrofonat dhe me kamerat. E di se është pjesë e punës, por mua nuk më pëlqen që të flas për veten", ka thënë Ndombele. Kante tashmë e ka treguar që rruge drejt suksesit nuk ka nevojë për një prezencë të madhe të medieve, që do t'i shërbejë mjaft mirë Ndombeles për ta kuptuar rolin e tij.

## Ibrahimovic rikthehet te Milani

Në ditëlindjen e 37-të të gjigantit suedez, Zlatan Ibrahimovic "Corriere della Sera" jep lajmin se ai mund të rikthehet te kuqezinjtë e Milanit, për të ndihmuar skuadrën të renditet në një nga katër vendet e para në fund të këtij sezoni, duke i siguruar një biletë për Ligën e Kampionëve. Edhe pse duhen edhe tre muaj që të hapet merkatoja e janarit, në shtëpinë kuqezija po zien gjithnjë e më shumë ideja për rikthimin në "San Siro" të Zlatanit, me të cilin në organikë Milani ka fituar për herë të fundit titullin në Serinë A në vitin 2011. Ideja për të tentuar Ibran mësohet se ka lindur nga kërkesa e trajnerit Gattuso për një tjetër sulmues "pykë", i cili do të ishte një mbështetje e madhe për Gonzalo Higuainin dhe Patrick Cutronen. Qëllimi është për të shkuar sa më larg të jetë e mundur në Europa League, trofe, që nëse do të fitohet, siguron pjesëmarrjen në Champions. Marrëveshja mes Ibrahimovicit dhe Los Angeles Galaxy përfundon në vitin 2019, por nuk përjashtohet mundësia që palët të gjejnë gjuhën e përbashkët për një lamtumirë më të shpejtë. Ideja e Milanit është të nënshkruajë me gjigantin suedez kontratë 6-mujore.



Publicitet

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – Tekst i konsoliduar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015), ndërsa në pajtim me Lajmërimin për mjetet e siguruar financiare për punësim për kohë të pacaktuar të punës në shkollat në vijim të Qytetit të Shkupit në bazë të financimit të vjetër me numër udhëheqës të veprës 18-13137/2 të datës 25.12.2017 të Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë, Lajmërimin për pëlqimin valid për realizim në vitin fiskal 2018 me numër udhëheqës të veprës 18-13137/4 të datës 15.01.2018 të Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë dhe Lajmërimin me pëlqim për punësim në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit për kohë të pacaktuar të punës në bazë të financimit të vjetër për vitin shkollor 2017/2018 me numër udhëheqës të veprës 12-1041/1 të datës 29.01.2018 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë dhe vendimit të U.D Drejtorit të Shkollës së Mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov" – Shkup, publikohet

### SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim të personave ndihmës-teknik (mirëmbajtës të higjienës dhe rojtar) për kohë të pacaktuar

1. Pesë mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës gjegjësisht 40 orë në javë, për kohë të pacaktuar të punës, me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar, shifra OBN 04 01 A01 002, me neto pagesë fillestare në shumë prej 12.165,00 denarë.

Orari i punës është me dy ndërrime prej ditës së hënë deri ditën e premte, fillimi dhe mbarimi i orarit ditor të punës në ndërrimin e parë është prej ora 06,00 deri në ora 14,00, ndërsa në ndërrimin e dytë është prej ora 12,00 deri në ora 20,00.

2. Një rojtar me orar të plotë të punës gjegjësisht 40 orë në javë, për kohë të pacaktuar të punës, me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar dhe kurs të mbaruar për zjarrfikës, shifra OBN 04 02 A01 001, me neto pagesë fillestare në shumë prej 12.165,00 denarë dhe shtesë për punë të natës në shumë prej 29% të bruto pagesës mujore.

Orari i punës me ndërrime është prej ora 20,00 deri në ora 06,00 dhe ditën tjetër sipas orarit të përgatitur më herët, si dhe kujdestari gjatë një të diele në muaj prej ora 08,00 deri në ora 20,00.

Dokumentet e nevojshme:

\* Lutje me CV;

\* Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (të vërtetuar në noter);

\* Certifikatë të shtetësisë;

\* Dëshmi për kurs të mbaruar për zjarrfikës për kandidatët nga pika 2 (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).

Shpallja zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet dorëzohen në adresën në vijim: Shkolla e mesme ekonomike dhe juridike e Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov"- Shkup, rr "Kosturska" pn – Shkup, tel. 02/2611-195, personi për kontakt është sekretari i shkollës.

SHMEJQSH "Arseni Jovkov" – Shkup

### REPUBLIKA E MAQEDONISË KOMUNA E STUDENIÇANIT Departamenti për urbanizëm, veprimtari komunale zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit jetësor

Në bazë të nenit 35 paragrafi 5 dhe paragrafi 8 dhe neni 51 paragrafi 10 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16), Kryetari i Komunës së Studeniçanit jep:

#### L A J M È R I M

Për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës Publike për DPUL për PK. 1448 dhe PK.1449, KK. Moranë V.Q.Isar, me klasë për qëllim A1- vendbanim në shtëpi banimi.

Dokumentacioni i Planifikimit Urbanistik Lokal DPUL për PK. 1448 dhe PK. 1449, KK. Moranë V.Q.Isar, me klasë për qëllim A1- vendbanim në shtëpi banimi do të jetë e publikuar para hyrjes në Komunën e Studeniçanit në periudhën prej datës 09.10.2018 deri 15.10.2018 çdo ditë pune prej orës 08:30 deri 16:30.

Përfshirja planifikuese është me sipërfaqe prej 0.310284 ha, dhe gjendet në anën verilindje kufizohet me rrugën Regjionale R 2131 Draçevë (lidhje me R 1106), Oreshan-Taor-Katllanovë (lidhje me R1102), nga ana perendimore kufizohet me rrugën egzistuese të dheet, në anën juglindore kufizohet me PK. 1447.Parcelat kadastrale të lëndës kanë qasje direkte në rrugën ekzistuese të dheet, e cila lidh me autobusin rrugë Regjionale R2131 Draçevë (lidhja me R1106)-Oreshan - Taor- Katllanovë (lidhje me R1102).

Prezantimi publik do të mbahet më datën 10.10.2018 në hapësirat e Komunës së Studeniçanit në ora 10.

Në afatin e përmendur ,banorët e interesuar dhe personat juridik nga rajon konkret i përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim,propozime dhe opinione të fletave anketuese.

Fletat anketuese do të mund të merren dhe plotësohen në zgjatje kohore të ekspozimit të planit çdo ditë pune prej ores 09-15 në hapësirat e komunës së Studeniçanit.

**Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093**



Kampionët në fuqi të Champions League ka pësuar humbje nga CSKA Moska në kuadër të xhiros së dytë të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve (1-0). Mbretërit pësuan gol që në minutën e dytë të ndeshjes, pas një gabimi trashanik të Toni Kroos

Kampionët në fuqi të Champions League kanë rënë në Moskë. Los Blancos janë mposhtur 1-0 nga CSKA me golin e vetëm të ndeshjes të shënuar që në minutën e 2'. Tre shtylla dhe shumë raste për Real, por fati nuk ishte me spanjollët këtë mbrëmje. Një start makthi i kampionëve në Moskë. Pas një pasimi të gabuar të Toni Kroos, diçka e rrallë por ja që ndodh, Nikola Vlasic nuk e shpërdoron dhuratën e mesfushorit gjerman duke mundur portierin Navas me një goditje të saktë në hyrje të zonës. Ndërkohë në ndeshjen tjetër të grupit G, Roma ka fituar pa probleme ndaj Plzen me rezultatin 5-0 falë tre golave të Edin Dzeko-s dhe realizimeve të Under me Kluivert. Të besuarit e Eusebio Di Francesco, pas disa javëve të vështira në kampionat dhe në Champions, duken të ringjallur dhe tashmë kanë filluar të luajnë me vetëbesimin që i karakterizoi sezonin e kaluar. Manchester United nuk ka arritur të shëojë fitore ndaj Valencias në një ndeshje të luftuar në Old Trafford. Sfidat përfundoi me rezultat 0-0. Bayern Munich ka dështuar që të fitojë në shtëpi ndaj Ajaxit. Ndeshja përfundoi me rezultat të barabartë 1-1. Zonja e Vjetër është treguar e pamëshirshme për zvicëranët e Young Boys të cilët i mposhti me rezultat 3-0. Manchester City ka fituar në udhëtim te Hoffenheim me rezultat 2-1 pas një ndeshje shumë të luftuar në Gjermani. Jose Mourinho u pyet për "kualitetin teknik" në ekipin e tij, pas barazimit pa gola të Manchester United ndaj Valencias, në "Old Trafford". "Djajtë e Kuq" bënë katër ndeshje pa fitore në të gjitha garat, duke regjistruar një tjetër paraqitje të dobët në ndeshjen e dytë të Ligës së Kampionëve. Duke folur pas ndeshjes së të martës në mbrëmje, Jose Mourinho duket se i paralajmëroi tifozët e Manchester United, që të mos presin shumë sukses nga sezoni 2018-2019. Portugezi pretendoi se nuk mund të ishte i sigurt në vlerësimin e tij, për shkak të kritikave të mëtejshme mbi metodat e punës. "Mendoj se ka gjëra, që është e vështirë për mua t'i them. Dhe nëse them diçka të këndshme..., do të ishte një arsye tjetër për të më kritikuar. Unë mendoj se e keni bërë këtë mjaft. Pra, preferoj vetëm të them se, kur sezonin e kaluar e përfunduam të dytë dhe shkuam në finale të "FA Cup", ne fituam grupin

LIGA E KAMPIONËVE

# KAMPIONËT BIEN NË MOSKË, DZEKO "RINGJALL" ROMAN



tonë në Ligën e Kampionëve. Dhe mendova se ishte një sezon fantastik. Ndaj Valencias, mendoj se barazimi ishte një rezultat i drejtë. Por, është frustrues për ne, sepse nuk është rezultati që duam. Kishite disa përmirësime në performancën tonë. Kishim një nivel të pranueshëm loje, në të kundërt do të humbnim. Dhe humbja do të na linte në një situatë të vështirë. Në një grup kaq të vështirë, nëse nuk mund të fitosh, të paktën mos humb. Ne ishim ekipi që u përpoq më shumë, që kishte disa shanse të mëdha për të fituar, por e pranoj rezultatin si të drejtë", ka deklaruar Mourinho. Pas humbjes së tretë të këtij sezoni dhe pas tri ndeshjeve radhazi pa shënuar asnjë gol, në media është raportuar se Real Madridi është duke kaluar në një krizë. Megjithatë, trajneri i klubit, Julen Lopetegui, e ka mohuar këtë duke thënë se nuk janë edhe aq të dobët. "Los Blancos" nuk kanë arritur të shënojnë gol për të tretën ndeshje radhazi për herë të parë që nga sezoni 2006/2007. Megjithatë, mbrëmë ata u mposhtën me rezultat 1-0 në Ligën e Kampionëve nga CSKA Moscow, por Lopetegui ka kërkuar nga tifozët që të rrinë të qetë. "Para 10

ditëve e mposhtën Romën dhe nuk ishim edhe aq të pathyeshëm. Ndërsa tani, nuk jemi edhe aq të dobët", ka thënë Lopetegui. "Ne duhet të vazhdojmë të tentojmë për të shënuar gola. Duhet të prodhojmë më shumë raste dhe do të jemi më të suksesshëm, nuk kam asnjë dyshim që skuadra do të shënojë dhe se fitoret do të vijnë. Ne nuk arritën të shënojmë në rastet e panumërta që i kishim. Na mungoi fati, tentuam nga distanca, nga qendra, përmes harkimeve. Kur e konsideron këtë, kemi pasur fat të keq". Real Madridi për momentin është në pozitën e tretë në grupin G të Ligës së Kampionëve, me pikë të njëjta me klubin e vendin e dytë, Romën. Trajneri i Bajernit Niko Kovaç tha se "ndoshta gjithçka u mor lehtë" nga Bayern Munich, paraprakisht, teksa gjigandi gjerman nuk shkoi më larg se barazimi 1-1 kundër Ajax, në ndeshjen e dytë të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve. Goli i hershëm i Mats Hummels u barazua nga Noussair Mazraoui. "Ndoshta gjithçka u mor lehtë nga ana jonë, por tani duhet të përvëshim mëngët. E dimë se nuk kemi fituar tri ndeshje dhe duhet të përqendrohemi përsëri në gjërat thelbë-

sore. Kjo nuk është ajo, që unë imagjinoja personalisht. Tani duhet të tregojmë me shpejtësi fytyrën e vërtetë, që na ka bërë kaq të mirë në shtatë ndeshjet e para. Ndaj Ajax nuk ishte një lojë e mirë nga ana jonë. Luajtëm shumë mirë në 15 minutat e para, pastaj treguam pakujdesi. Fituam shumë pak duela, çdo top i dytë ishte në favor të kundërshtarit", ka deklaruar Kovaç.

## GUARDIOLA: SILVA ËSHTË NJË NGA LOJTARËT MË TË MIRË QË KAM PASUR

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e ka quajtur mesfushorin spanjoll të skuadrës së tij, David Silvën, një nga lojtarët më të mirë që ai ka pasur ndonjëherë në skuadrat që i ka menaxhuar gjatë karrierës së tij. Manchester City arriti ta sigurojë fitoren e parë në këtë sezon të Ligës së Kampionëve mbrëmë, kur u ndeshën si mysafir me Hoffenheimin. Silva arriti ta shënojë golin e fitores në minutën e 87-të, duke e dërguar rezultatin në 2-1 për anglezët. Mesfushori 32-vjeçar ka qenë deri më tani një nga lojtarët më të rëndësishëm në skuadrën e Manchester Cityt, si në fillim të këtij sezoni, ashtu edhe

sezonin e kaluar kur u shpallën kampionë të Premierligës. Duke folur në konferencën për shtyp pas ndeshjes, Guardiola e lavdëroi Silva, duke thënë se ai është një nga lojtarët më të mirë ai ka pasur në skuadër dhe se është në të njëjtën listë me disa nga ish-lojtarët e tij të Bayern Munichit dhe Barcelonës. "Ai është një nga lojtarët më të mirë me të cilët kam punuar. Kam pasur shumë në Barcelonë dhe në Bayern, por edhe ai është në këtë listë", ka thënë Guardiola, skuadra e së cilit ishte mposhtur nga Lyoni në shtëpi, në ndeshjen e parë të këtij sezoni të Ligës së Kampionëve. "Mua më pëlqejnë lojtarët të cilët bëjnë një hap përpara kur jemi duke kaluar në një situatë të keqe dhe thonë: 'Në rregull, unë jam këtu djelmosha'".

## MODRIC: ATMOSFERA NË ZHVESHTOREN E REALIT NUK ËSHTË E MIRË

Mesfushori i Real Madridit, Luka Modrici, e ka pranuar se disfatat e mbrëmshme në Ligën e Kampionëve iu erdhin si befasi skuadrës madrilene, dhe për këtë arsye atmosfera në zveshtore nuk ishte më e mira. Real Madridi pësoi disfatë si mysafir në xhiron e dytë të grupit G të Ligës së Kampionëve, ata u mposhtën me rezultat 1-0 nga CSKA Moscow. Për momentin, "Los Blancos" radhitet në pozitën e tretë në këtë grup. Luka Modrici nuk ishte startues në këtë ndeshje, mirëpo u inkuadrua pas 58 minutave lojë, kur e zëvendësoi Casemiron, i cili u largua nga ndeshja për shkak të një lëndimi. Mirëpo, as kroati nuk arriti ta ndihmojë skuadrën e tij, të cilët u mposhtën për shkak të një goli që pranuan në minutën e dytë të ndeshjes. "Jemi të zemëruar. Ne nuk prisnim të humbnim pikë këtu dhe atmosfera në zveshtore nuk është më e mira për momentin. Duhet ta mbajmë kokën lart", ka thënë Modric, i cili këtë vit ka fituar çmimin e UEFA-s dhe FIFA-s për lojtarin më të mirë të vitit. "Në tri ndeshjet e fundit, veçanërisht kundër Sevillas dhe këtu, ne nuk ishim në formën tonë më të mirë. Luajtëm më mirë kundër Atleticos në pjesën e dytë. Është shqetësuese kur nuk shënon gola, por ne do ta gjejmë një zgjidhje. Ne duhet të jemi më pozitiv, të qëndrojmë së bashku, si dhe të punojmë më shumë për t'u përmirësuar dhe të fitojmë ndeshjen e radhës".

## KLUIVERT ME GOLIN NDAJ PLZEN THYEN DY REKORDE NË LIGËN E KAMPIONËVE

Justin Kluivert ka vendosur dy rekorde të reja, në momentin që e gjeti rrjetën në fitoren e Romës 5-0 në Ligën e Kampionëve ndaj Viktoria Plzen. Djali i ish-yllit të Milanit, Ajax dhe Barcelonës, Patrick Kluivert, gjeti golin e fundit në takim me çekët. Lojtari ka 19 vjet dhe 150 ditë, që e bën atë lojtarin më të ri që ka shënuar për Romën në versionin modern të Ligës së Kampionëve. Ky nuk ishte rekord

i tij i vetëm, pasi Kluivert është gjithashtu lojtari më i ri ndonjëherë holandez për të shënuar për një klub të huaj në këtë garë. Ai theu rekordin e Ola John për Benficën në vitin 2012, kur kishte 20 vjeç e 185 ditë. Kluivert ka kaluar këtë verë nga Ajax te Roma. Holandezi ka filluar ta gjejë vetën në Itali, ku kampionati njihet për mbrojtjen e fortë që e aplikon.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Kjo ditë do të jetë mjaft e rëndësishme dhe e mbushur me ngjarje të rëndësishme për karrierën tuaj aktuale. Horoskopi ju sugjeron që të shfrytëzoni më mirë këtë të mërkurë, për të përpunuar strategji të reja. Në dashuri do të jeni më romantik dhe pjesëmarrës lidhur me çështjet në çift.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Kjo ditë do të zhvillojë një interes të pazakontë, duke u thelluar mjaft në një raport. Megjithatë duhet të jeni gati të përballeni me ndryshime në vendin e punës, të cilat do ju detyrojnë të merrni vendime të rrufeshme.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Në vendin e punës duhet të jeni më të komunikueshëm, pasi do të keni mundësi që të forconi një raport apo aleancë. Lidhur me investimet dhe shpenzimet duhet të mendoheni mirë.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Mos u shfaqni shumë arrogant dhe impulsivë, pasi në këtë moment nëse doni të arrini një objektivin tuaj të qartë, duhet të prisni mundësitë që do ju ofrohen. Këshillohet që të veproni me sa më shumë diplomaci dhe të gjeni kompromis edhe në negociatat më të ndezura.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Mos u dekurajoni, nëse gjatë kësaj dite do të ndiheni disi të lodhur dhe melankolikë. Ky është një moment shumë i mirë për të marrë vlerësime të papritura, të cilat do ju rikthejnë sërish besimin në vetë.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Parashikohet një ditë e cila do ju lejojë që të rigjeni stabilitetin në jetën në çift. Këshillohet vetëm që të jeni më të përqendruar në vendin e punës.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Mund të merrni disa këshilla mjaft të vlefshme për zgjidhjen e disa të papriturave, të cilat gjatë javëve të fundit ju kanë shkaktuar nervozizëm. Në dashuri priten përgjigje të cilat do ju bëjnë mjaft euforik.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Kjo ditë do të jetë mjaft e qetë dhe nuk do të ndiheni aspak të lodhur. Veçse duhet të tregoni më shumë kujdes për anën tuaj emocionale. Parashikohen zhvillime të rëndësishme, por duhet të jeni të gatshëm që të bëni një hap të rëndësishëm në raport me partnerin/en.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Ky është një moment shumë i mirë për tu ushtruar dhe për të bërë eksperimente interesante, të cilat do ju lejojnë që të vini në zbatim, gjithë ato ide dhe projekte të cilat i keni mbajtur fshehur preh kohësh. Në dashuri, tashmë do të fitoni më shumë siguri, në raportin në çift dhe do të kuptoni më mirë se çfarë dëshironi.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Do të ndiheni të motivuar dhe do të përballeni me sfida të reja, të cilat do ju duken më të lehta. Megjithatë mundohuni të mos nënvlerësoni disa negociata, të cilat mund të ngadalësohen ndjeshëm. Në dashuri pritet të ketë shkëndija të rëndësishme.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt


Kjo ditë ju fton që të mos jeni negativ dhe ngacmues ndaj kolegëve tuaj, pasi do të keni nevojë për mbështetjen e tyre për realizimin e një projekti të ri. Këshillohet që gjatë së mërkurës të shmangni debatet në familje apo në dashuri.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Mundohuni të mos justifikoni sjelljen e një personi, pasi do të merrni përsipër përgjegjësi të mëdha në vendin e punës dhe ky është momenti i duhur për tu treguar më autoritar. Në dashuri ka disa keqkuptime të cilat duhen zgjidhur sa më parë.

| Mensur Mamuti                         | AKTORI AMERIKAN NË FOTO                        | SHKENCËTARI DHE SHAHISTI HUNGAREZ, ARPAD                | FUTBOLLISTI AMERIKAN, XHO                             | LIQEN NË KANADA<br>FILM ME AKTORIN NË FOTO | R   |
|---------------------------------------|--|---|---|--|---|
| FOLE                                  |  |   |   |  |   |
| AUTORI SLOVEN, REBULA                 |  |   |   |  |   |
| AUTORI FRENG, ROLAN                   |  |   |   |  |   |
| LITRI                                 |  | AKTORIA KROATE, RINA<br>ELEMENT KIMIK                   |   |  |   |
| TAKSË, TATIM NDAJ SHETIT              |  |   |   |  |   |
| AR (FRENGJ.)                          |  |   | URANI<br>NJËRA NGA KOORDINATAT (E KUNDERTA E ABHISES) |  | NJË KAFSHË SHTEPIAKE  |
| COF                                   |  |   |   |  |   |
| BANDË E EGËR GJAKATARE                |  |   |   |  |   |
| MAJË MIELLI                           |  |   |   | AUSTRIA                                    | VRAP KALI<br>VENDLINDJA E AKTORIT NË FOTO<br>ASTATI<br>FILM ME AKTORIN NË FOTO<br>FIZIKANI DANEZ, BOR |
| SUEDIA                                |  | BANORE E NJË SHETI AZIATIK<br>INDIAN I AMERIKËS VERIORE |   |  |   |
| KËNGËTARI KROAT, VARGA                |  |   | ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR, LALA                        |  |   |
| KËNGËTARJA KANADEZE, TARA             |  |   | NDAJFOLJE PYET SE                                     |  | LIDHJA HANSEATIKE<br>BASHKIM QELIZASH TË NJELLOUTA (SH. PASHQ.)                                       |
| NËPUNËS JURIDIK QË VËRTETON DOKUMENTE |  |   |   | NJË DIALEKT KINEZ<br>DAFINË                |   |
| KOHA                                  | BANOR I NJË KRAHINE SPANJOLLE<br>NOTË MUZIKORE |   |   |  | RUMANIA<br>ERANDA LIBOHOVA  |
| SIPËRFAQE E MADHE UJORE               |  |   |   | SUREJA E PESTË E KURANIT<br>METRI          | OKSIGJENI   |
| "VENDI MAGJIK" I FRANK BAUMIT         |  |   | FUTBOLLISTI BRAZILIAN, VIEIRA                         |  |   |



ZGJIDHJET: R, ÇERDHE, ALOJZ, ROMEN, L, ITA, TAGËR, OR, U, NGORDH, HORDHI, ENDE, B, S, IRAKIANE, TINI, ALTIN, ORAM, SI, LH, NOTER, NISU, KATALON, R, DET, MAIDE, OZ, MARSELO.

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |  |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|---|
| 1 |   |   |   |   |   | 8 |   |   | 3 |   | 1 |   |   | 9 | 8 |  | 4 |
|   |   |   |   | 8 | 9 | 2 |   |   | 6 |   |   | 4 |   |   |   |  | 9 |
|   |   |   |   |   | 2 | 1 | 7 | 3 |   | 5 |   |   | 8 |   |   |  | 7 |
|   | 9 | 8 |   | 4 |   |   |   |   | 4 |   |   |   |   |   |   |  | 9 |
|   | 4 |   |   |   |   |   | 3 |   |   |   | 3 |   |   |   | 2 |  |   |
|   |   |   |   | 7 |   | 9 | 8 |   |   | 2 |   |   |   |   |   |  | 8 |
| 5 | 1 | 9 | 2 |   |   |   |   |   |   | 3 |   |   | 4 |   |   |  | 5 |
|   |   |   | 3 | 7 | 9 |   |   |   |   | 1 |   |   |   | 7 |   |  | 6 |
|   |   |   | 6 |   |   |   |   | 2 |   | 5 | 7 | 1 |   |   | 4 |  | 2 |

Shumë i lehtë: 162357849, 734189256, 985462173, 3985441627, 647928531, 251673984, 519234768, 823796415, 476815392. Mesatar: 371659824, 682473519, 954281673, 465812397, 813794265, 729365148, 236948751, 148527936, 597136482.



# Gruaja e parë që fiton Nobelin në fizikë pas 55 vitesh

Çmimi Nobel në fizikë këtë vit i shkon edhe një gruaje, çka nuk ka ndodhur në 55 vitet e fundit. Dona Strickland, fizikania 59-vjeçare kanadeze, profesore në Universitetin e Vaterlosë u shpall fituese e Nobelit në fizikë për këtë vit, së bashku me amerikanin Artur Ashkin dhe francezin Zherar Moru'. Ajo është e treta në historinë e Nobelit në Fizikë që e merr këtë çmim.

Tre fizikantët u vlerësuan kontributin e tyre në përmirësimin e teknologjisë lazer të përdorur kryesisht në mjekësi. Ata kanë arritur të shumëfishojnë intensitetin e dritës lazer në pajisjet që në gjuhën shkencore njihen si "Pinceta Optike" dhe që përdoren kryesisht në ndërhyrjet kirurgjikale në sy.

Fuqizimi i energjisë lazer në këto pajisje i bën ato më precize gjatë ndërhyrjeve të tilla. Rrezet lazer përdoren



ren prej vitit 1985 për të prerë ose për t'i dhënë formë objekteve të ndryshe por edhe indeve të gjallesave. Tre fizikantët

do të ndajnë shpërblimin prej 1 milion, akorduar nga Akademia e Shkencave në Stokholm.

## Avokati 99-vjeçar që s'ka të ndalur

Attorney Morton Katz, 99 vjeç është bërë avokat që në 1951, pasi shërbeu në Luftën e II Botërore dhe vazhdon të punojë në bazë të kontratës me shtetin e Konektikut si një mbrojtës i veçantë publik. Katz e bën pothuajse të gjithë punën e tij vetë dhe në telefon, në vend që të përdorë kompjuterë, por ai i impresionon kolegët shumë më të rinj në moshë me mprehtësinë e tij të mendjes dhe kujtimin e detajeve. Ai nuk ka plane për të dalë në pension. Ai u diplomua nga Connecticut State College, shkolla që u bë Universiteti i Konektikut dhe pas marrjes pjesë në Luftën e Dytë Botërore në Afrikën e Veriut, Itali, Francë dhe Gjermani nisi shkollën e drejtësisë në UConn.



## Seks në parkingun e varrezave, çifti gjobitet me 20 mijë euro!

"Aventura seksuale" në parkingun e varrezave i ka kushtuar shtrenjtë një 42 vjeçari në Itali. Mbrëmja "hot" në makinë ka përfunduar me ndërhyrjen e policisë dhe një gjobe prej 20 mijë euro, nga 10 mijë për kokë për burrin dhe prostitutën me të cilën kreu marrëdhënies seksuale. Të dy

ishin fshehur në parkingun e varrezës kryesore në qendër të Padovës, por "performanca" e tyre tërhoqi vëmendjen e karabinierëve. Policia i ndërpreu teksa ishin të zhveshur dhe po kryenin aktin seksual. Gjopa ndaj tyre u lëshua pasi akuzohen për akte të turpshme në një vend publik.

## Këshilla e ekspertëve: Ndryshoni shpesh punën

Të ndryshosh punën shpesh është tendenca e re që po gjen përhapje të madhe jo vetëm në SHBA, por tashmë edhe në Europë. Dikur Andy Warhol thoshte që koha ndryshon gjërat, por në realitet duhet të jesh ti që duhet t'i ndryshosh ato. Ky citim është bërë sot motiv për botën e punës: të ndryshosh të paktën çdo dy vjet për të rritur pagën, për të reduktuar stresin, të jetosh situatat të reja që i japin vitalitet përditshmërisë dhe të merresh me projekte të reja që të rrisin intelektualisht, por edhe profesionalisht. Sipas statistikave më të fundit të agjencisë kaliforniane HR Robert Half, 64% e punonjësve janë "job hoppers" në SHBA, ky është termi i ri me të cilin është pagëzuar tendenca e re dhe ka një rritje në grafik me 22% në 4 vitet e fundit. Pjesa më e madhe që e



ka përqaftuar këtë trend janë të rinjtë dhe duket se koha e besnikërisë ndaj kompanisë nuk është më vlerë, por duket se fleksibiliteti po çmohet gjithnjë e më tepër. Duket se edhe studiuesit e sjelljeve njerë-

zore bien dakord me këtë tendencë të re të epokës në të cilën jetojmë, pasi sipas tyre kjo ndikon jo vetëm në pavarësinë profesionale, ekonomike, por edhe në vlera dhe reduktim stresi.

1227 - Vrasja e Kalifit El- Alid.  
1675 - Christian Huygens patenton orën e xhepit.  
1777 - Trupat e Gjen. George Washingtons sulmojnë britanikët në Germantown, Pa.  
1824 - Meksiko shpallet republikë.  
1830 - Qeveria kalimtare shpall ndarjen e Belgjikës nga Holanda.  
1854 - Abraham Lincoln mban fjalimin e tij të parë politik në pabinairin e Illinois.  
1880 - Themelohet Universiteti i Kalifornisë në Los Angeles.  
1910 - Portugalia shpallet republikë.  
1921 - Lidhja e Kombeve refuzon të ndihmojë Rusinë në krizën e urisë.  
1982 - Helmut Kohl zgjidhet kancelar i Gjermanisë Federale.

KALENDARI HISTORIK 4 TETOR



### PSE FËMIJËT DUHET T'I LEJONI TË QËNDROJNË ME QEN

Një hulumtim tregon se qentë mund të bëjnë terapinë e të folurit më efektive dhe njëkohësisht më argëtuese për fëmijët. Studiuesit zbulojnë se qentë mund t'i vënë fëmijët më lehtë për të folur. Për disa fëmijë, gjuha e të mësuarit mund të jetë shumë sfiduese, duke i bërë sesionet e terapisë së fjalës stresuese dhe jo shumë zbatues. Por gjithçka ndryshon kur në vend të tyre vendoset një kafshë si qeni. Studimi përfshiu 69 fëmijë me këtë problem. Studiuesit zbuluan se kur një qen terapeutik mori pjesë në seanca, fëmijët ishin më të aftë të imitonin sinjalet e komunikimit. Kjo përfshinte kopjimin e shprehjeve të fytyrës si ngushtimi i syve, mbyllja e syve, mbushja e faqeve me ajër dhe qeshur.

### ARSYETIMI I NXËNËSIT

Del gjyshi dhe e thërret Benin nga dritarja:

- Beni mor Beni, hajde futu shpejt në shpi se po kalon mësuesja jote e të shef duke luajtur, a i ke thënë që do mungojë se jam i sëmurë.
- Jo jo gjyshi, futu ti shpejt brenda se i kam thënë se më vdiq gjyshi.



Tradicionalistët janë pesimistë për të ardhmen dhe optimistë për të shkuarën.  
**(Lewis Mumford)**



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS